



STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE E REFORMËS NË ADMINISTRATËN PUBLIKE

2015 – 2020

Raporti Vjetor i Monitorimit

2017

Tiranë, Prill 2018

Pasqyra e Lëndës

I. Përbledhje Ekzekutive	5
II. Hyrje	10
III. Vlerësim i përgjithshëm mbi progresin e strategjisë.....	12
IV. Progresi i zbatimit të reformave në kuadër të secilit prioritet	17
<i>Shtylla I: Politikëbërja dhe Cilësia e Legjislacionit</i>	17
<i>Shtylla II: Organizimi dhe Funksionimi i Administratës Publike</i>	27
<i>Shtylla III: “Shërbimi civil: Menaxhimi i Burimeve Njerëzore”</i>	35
<i>Shtylla IV: Procedurat Administrative dhe Mbikëqyrja.....</i>	46
IV. Sfidat kryesore për zbatimin e Strategjisë në 2018	55

LISTA E AKRONIMEVE:

ADISA - Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integrues

AFMIS - Sistemi i Menaxhimit Financiar

BE - Bashkimi Evropian

DAP - Departamenti i Administratës Publike

EAMIS - Sistemi i Menaxhimit të Asistencës së Huaj

HRMIS - Sistemi Informatik i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore

ICSP - Dokumenti Strategjik i Shtetit

IPSIS - Sistemi i Planifikimit të Integruar të Menaxhimit të Informacionit

KDIMDP - Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

KE – Komisioni Evropian

KPI - Indikatorët Kyç të Performancës

KPP - Komiteti i Përherershëm i Pranimit

ML - Ministri Linje

NC - Nëpunës Civil

OECD – Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik

OJF - Organizatë Jofitimprurëse

OSS - One Single System (Një Sistem i Vetëm)

OZHM - Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm

PBA - Programi Buxhetor Afatmesëm

PFM - Menaxhimi i Financave Publike

PKIE - Plani Kombëtar për Integrimin Evropian

RENjK - Regjistri Elektronik për Njoftimin dhe Konsultimin Publik

RIA - Vlerësimi i Ndikimit Regullator

OECD/SIGMA – Support for Improvement in Governance and Management

SKZHI - Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim

SNRAP - Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike

SPI - Sistemi i Planifikimit të Integruar

TIK – Teknologja e Informacionit dhe Komunikimit

I. Përbledhje Ekzekutive

Raporti vjetor i monitorimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike 2015- 2020 ka për qëllim të prezantojë progresin e përgjithshëm të zbatimit të Strategjisë bazuar në katër shtyllat kryesore të saj si dhe nivelin e arritjes së objektivave respektive për vitin 2017.

Gjatë vitit 2017, puna drejt zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike u fokusua në dy drejtime kryesore: (i) *vlerësimin afatmesëm të Strategjisë dhe hartimin e planit të ri të aktiviteteve për periudhën 2018-2020* (ii) *zbatimin e aktiviteteve të parashikuara në strategji për periudhën 2015 – 2017*.

Sikurse përcaktohet edhe në dokumentin Strategjik të miratuar në 15 Prill, 2015, Strategja i'u nënshtrua një procesi vlerësimi afatmesëm, i cili përfundoi në tre-mujorin e dytë të vitit 2017. Vlerësimi përfshiu periudhën 2015-2017 dhe shërbeu për të evidentuar arritjet gjatë dy viteve të para të zbatimit të strategjisë në pikëpamje të rezultateve të parashikuara dhe të nivelit të arritjes së objektivave. Ky vlerësim shërbeu gjithashtu edhe si një bazë e mirë për orientimin e përcaktimit të prioriteteve për periudhën 2018-2020 si dhe për të evidentuar nëse duhet të rishikohen treguesit apo objektivat e parashikuara.

Në vijim të vlerësimit afatmesëm si dhe ristrukturimit të administratës qendrore shtetërore, Departamenti i Administratës Publike, me mbështetjen e OECD/SIGMA, nisi punën për hartimin e Planit të Ri të Veprimit 2018-2020, proces ky i cili filloi gjatë tremujorit të katërt të vitit 2017.

Gjatë hartimit të këtij plani, u morën në konsideratë arritjet dhe sfidat e hasura gjatë zbatimit të Strategjisë bazuar në gjetjet dhe rekomandimet e reflektuara në vlerësimin afat-mesëm. Ndër të tjera, gjatë fazës së hartimit të aktiviteteve të reja, u konsideruan dhe reflektuan rast pas rasti rekomandimet e Raportit Vjetor të Komisionit Evropian për Shqipërinë, vlerësimi vjetor i SIGMA, konkluzionet e takimit të shtatë të Grupit të Posacëm për Reformën në Administratën Publike¹, si dhe prioritetet e kabinetit të ri qeveritar. Kujdes u tregua edhe ndaj evidentimit të aktiviteteve të parealizuara gjatë periudhës 2015-2017 për t'u përfshirë në planin e ri të aktiviteteve. Fokus i veçantë iu kushtua financimit të aktiviteteve, për të siguruar që plani i ri të bazohet në burime të qarta financiare dhe me një nivel shumë të ulët të boshllëkut finanziar. Në këtë mënyrë mund të garantohet qëndrueshmëria financiare e planit që në hartimin e tij.

Plani i Ri i Veprimit për periudhën 2018-2020 duhet të reflektojë ndryshime të mundshme të aktiviteteve duke i kushtuar vëmendje të veçantë afateve kohore dhe burimeve të financimit për realizimin e masave për të siguruar një Plan të Ri Veprimi sa ambicioz aq edhe të arritshëm.

Pas bashkëpunimit me të gjitha institucionet, pjesë të kësaj Strategjie, draft-plani i hartuar bashkarisht u publikua në faqen e DAP dhe të gjithë të interesuarit u ftuan për të dhënë komentet dhe sugjerimet e tyre mbi këtë plan². Për më tepër, gjatë muajit Prill, ZëvendësKryeministri dhe

¹ Takimi i Shtatë të Grupit të Posacëm për Reformën në Administratën Publike BE-Shqipëri, u zhvillua në Tiranë me datë 27 Shtator, 2017

²<http://dap.gov.al/publikime/dokumenta-strategjik/186-test-draft-plani-i-ri-i-aktiviteteve-2018-2020>

Departamenti i Administratës Publike organizuan dy tryeza konsultimesh me shoqërinë civile dhe partnerët ndërkombëtarë për të diskutuar mbi planin e ri të aktiviteteve dhe për të finalizuar këtë dokument të rëndësishëm në bashkëpunim me të gjitha palët e interesit.

Paralelisht me punën përgatitore për hartimin e planit të ri të aktiviteteve, Departamenti i Administratës Publike ka vijuar monitorimin e matjes së ecurisë së aktiviteteve në mënyrë periodike përgjatë gjithë vitit.

Gjetjet e raportit vjetor për vitin 2017 janë inkurajuese pavarësisht ndikimit të zgjedhjeve parlamentare, situatës parazgjedhore dhe ristrukturimit të administratës qendrore. Tre vite pas fillimit të zbatimit të strategjisë në Prill 2015, të dhënët tregojnë se 80%³ e aktiviteteve të parashikuara në Strategji janë nën zbatim, ndërsa 45 prej tyre janë realizuar plotësisht, duke shënuar një rritje prej 14 produkte, krahasimisht me vitin 2016. Gjatë vitit 2017, situata parazgjedhore, e cila çoi në emërimin e ministrave dhe drejtuesve teknikë në krye të disa institucioneve të pavarura, pati një ndikim negativ në ecurinë e strategjisë pasi vëmendja e institucioneve ishte drejt sigurimit të moshpërdorimit të burimeve njerëzore gjatë fushatës elektorale. Në vijim të zgjedhjeve parlamentare, administrata qendrore shtetërore kaloi nëpërmjet një procesi ristrukturimi çka shkaktoi ngadalësi në vijimin e punës drejt zbatimit të aktiviteteve të Strategjisë. **Megjithatë, ecuria e zbatimit mbeti pozitive dhe shënoi rritje.**

Në pikëpamje të përmirësimit të sistemit politikbërës dhe cilësisë së legjislacionit, Shqipëria ka ndërmarrë tashmë hapat e nevojshme për të zbatuar sistemin e Vlerësimit të Ndikimit Rregullator (RIA)⁴. U Miratua versioni i parë i Metodologjisë për Vlerësimin e Ndikimit Rregullator për të vijuar me pilotimin e zbatimit të kësaj Metodologjie si dhe u ngrit Rrjeti RIA, me përfaqësues nga Kryeministria dhe të gjitha ministritë e linjës, me synimin për të çuar përpara dhe zbatuar vlerësimin e ndikimit rregullator në Shqipëri.

Ka patur ecuri pozitive në drejtim të ngritjes së sistemeve të menaxhimit të informacionit që do të kontribojnë në përmirësimin e planifikimit dhe koordinimit të politikave: IPSIS⁵, AFMIS⁶ dhe EAMIS⁷. Këto sisteme do të sigurojnë një menaxhim të integruar të informacionit me qëllim planifikimin dhe monitorimin e integruar të politikave strategjike dhe menaxhimin financiar/ndihmën e huaj përmes një sistemi të integruar të mirëqeverisjes.

Zhvillime janë bërë edhe sa i takon plotësimit të mekanizmave ligjore e insititucionale që sigurojnë pjesëmarrjen e publikut në konsultimin e politikave publike. Regjistri Elektronik për Njoftimin dhe Konsultimin Publik (RENjK) tashmë është ngritur dhe është i aksesueshëm për publikun⁸. Me riorganizimin strukturor të administratës qendrore, janë përcaktuar qartë edhe

³ 66 produkte nga 82 gjithsej

⁴ Kjo praktikë synon përmirësimin cilësor të praktikave të zhvillimit të politikave, si dhe kryerjen e analizave më të thelluara të akteve ligjore, para miratimit të tyre.

⁵ Sistemi i Planifikimit të Integruar të Menaxhimit të Informacionit

⁶ Sistemi i Menaxhimit Financiar

⁷ Sistemi i Menaxhimit të Asistencës së Huaj

⁸ Për vitin 2017, ndër 33 akte ligjore nga Këshilli i Ministrave (7 Strategji/Plane Veprimi dhe 26 projektligje), 29 prej tyre i janë nënshtruar procesit të konsultimit Publik.

përgjegjësitë institucionale sa i takon procesit të monitorimit të konsultimit publik, duke vendosur përgjegjësinë brenda strukturës së Kryeministrisë.

Në drejtim të përmirësimit të mënyrës së organizimit dhe funksionimit të administratës publike, **është rikonceptuar mënyra sesi ofrohen shërbimet për qytetarët, me një përqasje gjithëpërfsirëse dhe të qendëruar tek qytetari.**

Gjatë gjysmës së dytë së vitit 2017, nisi ristrukturimi i ministive të linjës, si një përgjigje ndaj nevojës që buron nga ndryshimet aktuale në formatimin e kabinetit qeveritar dhe fushat e reja të përgjegjësisë së tyre si rezultat i ndryshimit të portofoleve ministrore, problematikave të identifikuara në 4 vjeçarin e parë të qeverisjes dhe integrimit të ekspertit qeverisës horizontalisht dhe vertikalisht, në një sistem të integruar qeverisës. Qëllimi i kësaj reforme është garantimi i një administrative publike mirëfunkcionale, transparente dhe eficiente, e aftë për t'ju përgjigjur nevojave të qytetarëve përsa i përket ofrimit të shërbimeve publike.

Progres i mëtejshëm u bë në lehtësimin e ofrimit të shërbimeve publike, gjatë vitit 2017, me hapjen dhe të tre qendrave të integruara të ofrimit të shërbimeve në Krujë, Fier dhe Gjirokastër. **Për më tepër, po në kontekstin e përmirësimit të ofrimit të shërbimeve, është krijuar sistemi i menaxhimit të ankesave** si një mekanizëm për menaxhimin e ankesave të paraqitura nga qytetarët në Qendrat e Integruarë ADISA.

Në drejtim të përmirësimit të kapaciteteve për zbatimin e legjislativit të shërbimit civil dhe menaxhimit të burimeve njerëzore, janë vlerësuar kapacitetet e burimeve njerëzore sa i takon përditësimit dhe përfitimit të njojurive shtesë të mbi 1300 nëpunësve civilë në pozicione me funksione inspektimi me qëllim aftësimin e nëpunësve civilë dhe pajisjen e tyre me njojuritë shtesë sipas funksioneve dhe fushës ku ata veprojnë për të rritur më tej cilësinë e punës në institucionet e administratës.

Është përmirësuar më tej procesi i rekrutimit dhe plotësimit të nevojave institucionale. Gjatë vitit 2017, janë ndërmarrë një sërë masash në drejtim të rritjes së objektivitetit në procesin e testimit, pasurimit dhe përmirësimit cilësor të bankës së pyetjeve për proceset e rekrutimit në shërbimin civil, përgatitjes së një sërë materialesh orientuese për t'i ardhur në ndihmë të gjithë aplikantëve potencialë, trajnimit të anëtarëve të Komiteteve të Përherershme të Pranimit mbi metodologjinë dhe teknikat e sakta të vlerësimit të kandidatëve, bashkëpunimit me institucionet e arsimit të lartë me qëllim informimin e kandidatëve potencialë (studentët dhe të sapodiplomuarit), lidhur me mundësitet e punësimit në administratën shtetërore, etj. Sa i takon zbatimit të planit vjetor të rekrutimit, në konteksin e emërimit të ministrave teknikë dhe monitorimit të burimeve njerëzore gjatë fushatës elektorale, për të eliminuar çdo përdorim të burimeve shtetërore gjatë kësaj periudhe, me qëllim garantimin e paanshmërisë së procesit zgjedhor, procedurat e konkurrimit u pezulluan për një periudhë disa mujore; gjë kjo e cila solli edhe një përqindje më të ulët të zbatimit të planit të rekrutimit krahasimisht me vitet e kaluara.

Shtrirja e Sistemit Informatik të Manaxhimit të Burimeve Njerëzore (HRMIS) vazhdon të mbetet një prioritet i rëndësishëm. Është bërë e mundur që të hidhen në sistem mbi 550 institucione dhe informacioni për mbi 45,000 të punësuar. Ndër të tjera, janë trajnuar punonjësit e burimeve njerëzore si dhe financës si përdorues të Sistemit Informatik të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (HRMIS). Vlen për t'u theksuar se gjatë 2017 janë hedhur **hapa konkrete drejt mundësimit të gjenerimit të pagave të punonjësve të administratës nëpërmjet HRMIS**, proces ky i cili po pilotohet në 30 institucione shtetërore.

Në drejtim të përmirësimit të procedurave administrative dhe mbikëqyrjes, vëmendje e veçantë është vijuar t'i kushtohet rishikimit të procedurave për ofrimin e shërbimeve ndaj publikut dhe thjeshtimin e tyre, duke përfshirë zgjidhje TIK në rastet kur është e mundur si dhe duke marrë në konsideratë Kodin e Ri të Procedurave Administrative.

Zhvillime ka patur edhe sa i takon shërbimeve online që mundësojnë ofrimin e më shumë shërbimeve elektronike për qytetarët, bizneset dhe administratën. Aktualisht, portali qeveritar e-Albania ofron 535 shërbime elektronike dhe 47 sisteme shtetërore bashkëveprojnë me njëra-tjetrën për të garantuar komunikim në kohë reale mes qytetarit dhe institucioneve publike. **Vula dixhitale dhe moduli i administratës publike për nxjerrjen e dokumenteve administrative për qytetarin** është një risi e portalit e-albania⁹ gjatë vitit 2017.

Zhvillime pozitive ka patur edhe në vënien në zbatim të programit institucional të transparencës nga autoritetet publike sidomos në rastin e institucioneve të pavarura dhe bashkive. Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrotjtjen e të Dhënavë Personale ka vijuar mbikëqyrjen mbi zbatimin e Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, nëpërmjet monitorimit të elementeve të ndryshëm të ligjit si: numri i autoriteteve publike që kanë hartuar programet e transparencës, koordinatorë të caktuar nga autoritetet publike, përditësimi i regjistratës së kërkuesave dhe përgjigjeve, numri i ankesave të shqyrtuara, hetimet e kryera, seanca dëgjimore të zhvilluara si dhe vendimet e dhëna. **181** autoritete publike kanë miratuar dhe kanë bërë publik programin e transparencës; **227** autoritete publike kanë caktuar koordinator për të drejtën e informimit dhe **124** Autoritete Publike kanë publikuar registrin e kërkuesave dhe përgjigjeve.

Me synim zbatimin korrekt të Kodit të Procedurave Administrative, janë ndërmarrë një sërë masash në pikëpamje të hartimit të materialeve orientuese për t'i ardhur në ndihmë qytetarëve, janë hartuar disa formate standarde të lidhura drejpërdrejtë me parashikimet e Kodit si dhe është punuar në drejtim të vlerësimit të përafrimit të ligjeve sektoriale në përpunim me këtë Kod. Janë zhvilluar seanca informimi, me mbi 400 të trajnuar të niveleve të ndryshme, përfshirë administratën qendrore dhe institucionet e pavarura, mbi risitë dhe ndryshimet që burojnë nga

⁹ Portali e-Albania përdoret nga punonjësit e administratës publike për të marrë vërtetime dhe dokumente të cilat gjenden si shërbime të portalit (me vullë dixhitale) për plotësimin e dokumentacionit shoqërues të shërbimit të kërkuar nga qytetari. Këto dokumente nuk i kërkohen më vetë qytetarit gjatë marrjes se një shërbimi publik.

Kodi. Në kuadër të Projektit të Binjakëzimit “*Mbështetje për Reformën e Shërbimit Civil në Shqipëri*” të financuar nga Bashkimi Evropian, është kryer edhe Trajnim i Trajnerëve fokusuar në metodat për përcjelljen e njohurive mbi Kodin, përmbajten e trajnimit dhe aftësitë trajnuese të trajnerëve.

Përpos arritjeve dhe ecurisë në zbatimin e strategjisë përgjatë vitit 2017, vlen të përmenden edhe sfidat me të cilat jemi përballur gjatë kësaj periudhe. Potencialisht këto sfida mund të kishin një ndikim të drejtëpërdrejtë negativ në ecurinë normale të punës dhe rrjedhimisht edhe zbatimit të Strategjisë. *Situata parazgjedhore, qeveria teknike, apo ristrukturimi mund të ndikonin drejtëpërdrejtë apo në mënyrë indirekte në funksionimin normal të administratës. Megjithatë, të dhënët tregojnë se krahasimisht me vitin e kaluar, kemi një rritje prej 4% të aktiviteteve nën zbatim.* Me formatimin e kabinetit të ri qeveritar por edhe ristrukrutimin e administratës qendrore, institucionet vijuan punën normalisht në pjesën më të madhe të rasteve, duke vazhduar të raportojnë mbi ecurinë e zbatimit të Strategjisë, qoftë gjashtë majorin e parë të vitit 2017, qoftë në atë të dytin.

Edhe pse elementët e mësipërm shkaktuan vonesë në procesin e hartimit të Planit të ri të Aktiviteteve për periudhën 2018-2020, për shkak të formimit të një kabineti të ri qeveritar, ndryshimit të numrit të ministrive nga 16 në 11 por edhe rishpërndarjen e përgjegjësive bazuar në organizimin e ri, *me përfundimin e ristrukturimit dhe pozicionimin e nëpunësve ekzisutes brenda strukturave të reja, puna për hartimin e planit të ri vijoi intensivisht.* Në këtë kontekst, gjatë tre majorit të fundit të vitit 2017 dhe tre-majorit të parë të vitit 2018, u punua bashkarisht për të hartuar një plan të mirë, me aktivitete të qarta, të matshme, ambicioze por edhe të arritshme, me fokus të vecantë mbi financimin e aktiviteteve dhe shmangjen e boshllékut finanziar, një ndër sfidat me të cilat jemi hasur gjatë tre viteve të zbatimit të kësaj strategjie.

Përgjatë tre viteve të ardhshme, puna do të fokusohet drejt arritjes së objektivave të strategjisë duke siguruar ecurinë e zbatimit të planit të aktiviteteve dhe monitorimin e vazhdueshëm të Strategjisë.

II. Hyrje

Reforma në administratën publike në Shqipëri mbetet thelbësore në procesin e integrimit të vendit në Bashkimin Evropian. Një administratë publike profesionale, e bazuar në meritokraci dhe e aftë për të ofruar shërbime cilësore ndaj publikut, është një parakusht për qeverisjen transparente dhe demokratike. Një kornizë strategjike e mirëpërcaktuar përbën themel mbi të cilat do të ndërtohet zbatimi i reformës në administratën publike.

Strategja Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike, e miratuar në muajin Prill 2015, shërben si një dokument strategjik që orienton reformimin e administratës, bazuar në katër shtylla kryesore, objektiva të qarta dhe një plan veprimi me aktivitete konkrete.

Dhënia e rekomandimit të Komisionit Evropian për të hapur procesin e negociatave me Shqipërinë shënon një hap të rëndësishëm përparrë në procesin e integrimit evropian, proces i cili kërkon një administratë profesionale dhe kapacitete njerëzore e materiale për të mundësuar jetësimin e politikave dhe objektivave kombëtare.

Në këtë kontekst, Strategjia udhëhiqet nga vizioni:

“Zhvillimi i një administratë publike që siguron shërbime më cilësi të lartë për qytetarët dhe bizneset në mënyrë transparente, efektive, dhe efikase, nëpërmjet përdorimit të teknologjive moderne dhe shërbimeve inovative dhe përputhet me kërkesat e integrimit evropian, nëpërmjet nëpunësve civilë të paanshëm, profesionalë dhe të përgjegjshëm, pjesë e strukturave eficente”.

Zbatimi i saj mbështetet në reformat që duhet të ndërrmerren në katër shtylla kryesore prioritare që synojnë përmirësimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të :

- i. Sistemit të Politikëbërjes dhe Cilësisë së Legjisacionit;
- ii. Mënyrës së Organizimit të Administratës Publike;
- iii. Shërbimit Civil dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore;
- iv. Procedurave Administrative dhe Mbikëqyrjes;

Zbatimi i Strategjisë realizohet nëpërmjet aktiviteteve të parashikuara në Planin e Aktiviteteve. Për të mbikëqyrur securinë e progresit të bërë për realizimin e aktiviteteve, funksionon një proces i rregullt monitorimi dhe vlerësimi. Gjatë periudhës 2015-2017 janë përgatitur 12 raporte periodike të cilat kanë në fokus monitorimin e vazhdueshëm të realizimit të aktiviteteve.

Ndërkohë arritjet e zbatimit të strategjisë dhe impakti i saj vlerësohet mbi baza vjetore, nëpërmjet vlerësimit të treguesve të suksesit të përcaktuar sipas objektivave të Strategjisë. **Ky është raporti i tretë i monitorimit vjetor të Strategjisë dhe vlerësimit të arritjeve bazuar mbi objektivat.**

Raportet e monitorimit hartohen në bashkëpunim me të gjitha institucionet e përfshira si dhe diskutohen në Grupin Tematik përkatës, e më pas miratohen në Grupin për Menaxhimin e Integruar të Politikave për Mirëqeverisjen dhe Administratën Publike.

Zhvillimet dhe hapat e ndërmarrë nga Shqipëria sa i takon përbushjeve të objektivave të Strategjisë Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike në të katër shtyllat e saj,


synojnë **përmbushjen e vizionit të kësaj Strategjie dhe forcimin e një administratë profesionale, të aftë dhe të ndërgjegjshme për rolin e saj në procesin e integrimit të Bashkimit Evropian.**

Si një ndër pesë prioritetet e Shqipërisë për t'u përbushur me qëllim hapjen e negociatave, reforma në administratën publike kërkon angazhim serioz, këmbëngulje për të përballuar sfidat që parashtron, mbështetje të vazhdueshme por mbi të gjitha kërkon përfshirje dhe kontribut ndër-institucional.

Fokus është dhe do të vijojë të mbetet përforcimi i një administratë publike profesionale, me shërbyes civil dhe punonjës të cilët punojnë mbi vlerat të përbashkëta dhe ushtrojnë funksionet e tyre me integritet.

III. Vlerësim i përgjithshëm mbi progresin e strategjisë¹⁰

Plani i Veprimit 2015-2017, parashikon ***zbatimin e 53 aktiviteteve bazë dhe 82 produkteve në total***. Deri në fund të vitit 2017, nga 82 produkte në total, ***66 prej tyre janë nën zbatim (ose 80% e totalit)*** (Grafiku1). Prej tyre, 45 produkte vlerësohen si të realizuara plotësisht, duke shënuar sërish një rritje prej 14 produktesh krahasimisht me 31 produkte të realizuara plotësisht në vitin 2016.



Ajo çka vlen të përmendet është se çdo vit zbatimi i aktiviteteve të Strategjisë është në rritje dhe përpas sfidave zbatimi ka vijuar normalisht, ***duke treguar një tendencë pozitive të ecurisë së SNRAP në pikëpamje të përbushjes së objektivave***.

Gjatë vitit 2017, situata parazgjedhore, e cila u shoqërua me disa ndryshime në kabinetin e qeverisë dhe drejtues teknikë në krye të disa institucioneve të pavarura, pati një ndikim negativ në ecurinë e strategjisë pasi ritmi i zbatimit për disa nga aktivitetet pësoi ulje. Në vijim të zgjedhjeve parlamentare, administrata qendrore shtetërore kaloi nëpërmjet një procesi ristrukturimi çka shkaktoi ngadalësi në vijimin e punës drejt zbatimit të aktiviteteve të Strategjisë. ***Pavarësisht kësaj situate, edhe pse jo me ritmet e duhura, ecuria e zbatimit mbeti pozitive***.

Vlerësimi i nivelit dhe statusit të zbatimit të aktiviteteve të SNRAP për vitin 2017 bazohet mbi informacionin e dhënë nga çdo njësi përgjegjëse. Departamenti i Administratës Publike ka kryer vlerësimin e informacionit gjatë tre muajit të parë të vitit 2018 dhe vijoi me hartimin e raportit në muajin Prill.


¹⁰ Vlerësimi i zhvillimeve për vitin 2017, në pikëpamje të arritjes së objektivave të Strategjisë realizohet nëpërmjet vlerësimit të indikatorëve (treguesve të suksesit) të parashikuar në dokumentin e Strategjisë, ndërkohë që vlerësimi i ecurisë së zbatimit të reformave të parashikuara në kuadër të strategjisë bazohet në vlerësimin e ecurisë së zbatimit të aktiviteteve të parashikuara në Planin e Veprimit.

Në vijim të prezantimit të situatës si më sipër, nga një total prej 66 produkteve nën zbatim (ose 80%), **45 (ose 68%) prej tyre janë realizuar plotësisht deri në fund të viti 2017**. Krahasimisht me raportin e vitit 2016, shënohet një rritje me 4% e totalit të produkteve nën zbatim (Grafiku 2).


Numri i produkteve nën zbatim për secilën nga shtyllat është:

- i. *Shtylla I: “Politikëbërja dhe Cilësia e Legjislacionit”* (25 produkte nga 30 në total);
- ii. *Shtylla II: “Organizimi dhe Funksionimi i Administratës Publike”* (7 produkte nga 10 në total);
- iii. *Shtylla III: “Shërbimi civil: Menaxhimi i Burimeve Njerëzore”* (18 produkte nga 25 në total);
- iv. *Shtylla IV: “Procedurat Administrative dhe Mbikëqyrja”* (16 produkte nga 17 në total)

Grafiku 3. Numri i produkteve nën zbatim sipas Shtyllave



Grafiku 4. Statusi i realizimit të produkteve sipas Shtyllave




Grafikët më sipër paraqesin një situatë krahasuese në lidhje me statusin e vazhdueshëm të punës në fushat prioritare. Siç tregojnë grafikët, numri i produkteve “outputeve” të cilat janë nën zbatim është :

- > Nën Shtyllën I (*25 produkte nga 30 në total, duke shënuar një rritje me 2 produkte nga raportimi i vitit 2016*);
- > Nën Shtyllën II, (*7 produkte nga 10, shifër kjo e njëjtë krahasimisht me periudhën e mëparshme të raportimit*).
- > Nën Shtyllën III (*18 produkte nga 25 në total, duke shënuar një rritje prej 1 produkti më tepër krahasuar me periudhën e mëparshme të raportimit*).
- > Nën Shtyllën IV (*16 produkte nën zbatim nga 17, duke shënuar një rritje me prej 1 produkti më tepër krahasuar me periudhën e mëparshme*).

Nisja e disa aktiviteteve¹¹ ka qenë e kushtëzuar me ecurinë në fillimin e zbatimit të projektit IPA 2014 “Zbatimi i reformës së shërbimit civil në administratën publike”, i cili pritet të nisë brenda viti 2018.

Grafiku 5. Ecuria e realizimit të produkteve deri në fund të vitit 2017



Në përgjithësi, për të katër shtyllat, përqindja e aktiviteteve në zbatim është mbi 70%.

Krahasimisht, në grafikun nr 5. jepet ecuria e produkteve të realizuara plotësisht prej fillimit të batimit të Strategjisë në vitin 2015. Pra, sic hihet, *numri i produkteve të realizuara në vitin 017 është 9 herë më i madh se në vitin 2015.*

Në pikëpamje të përmirësimit të sistemit olitikëbërës dhe cilësisë së legjislacionit¹², *Shqipëria ka ndërmarrë tashmë hapat e nevojshme për të zbatuar sistemin e Vlerësimit të Ndikimit Regulator (RIA).*

Ky sistem i ri synon përmirësimin cilësor të procesit të zhvillimit të politikave bazuar në kryerjen e analizave më të thelluara të akteve ligjore, para miratimit të tyre. Vlerësimi i Ndikimit, i cili tashmë është i detyrueshëm¹³, do të mundësojë gjithashtu rritjen e transparencës dhe përmirësimin e cilësisë së hartimit të legjislacionit. Me mbështetjen e ofruar nga ekspertët e OECD/SIGMA, gjatë vitit 2017, është miratuar versioni i parë i *Metodologjisë për Vlerësimin e Ndikimit Rregulator*¹⁴ për të vijuar me pilotimin e zbatimit të kësaj Metodologjie. Gjatë muajit shkurt 2018 është ngritur “Rrjeti RIA”, me përfaqësues nga Kryeministria dhe të gjitha ministritë e linjës, me synimin për të çuar përpara dhe zbatuar vlerësimin e ndikimit rregulator në Shqipëri.

Ka patur ecuri pozitive për zhvillimin e tre sistemeve të menaxhimit të informacionit: IPSIS¹⁵, AFMIS¹⁶ dhe EAMIS¹⁷ *me qëllim planifikimin dhe monitorimin e integruar të politikave strategjike dhe menaxhimin finanziar/ndihmën e huaj përmes një sistemi të integruar të mirëqeverisjes.*

Janë plotësuar mekanizmat ligjore e insitucionale që sigurojnë pjesëmarrjen e publikut në konsultimin e politikave publike. Regjistri Elektronik për Njoftimin dhe Konsultimin Publik

11 si psh. nën Objektivin 7 “Organizimi i sistemit të pagave në shërbimin civil duke u bazuar në vlerësimin e vendit të punës, të arritjeve vjetore të nëpunësve civilë dhe rezultateve në trajnimet e detyrueshme” do të nisin pas fillimit të implementimit të projektit Projet IPA 2014 “Zbatimi i reformës së shërbimit civil në administratën publike”.

12 Reformw e parashikuar nwn shtyllwn I

13 Me qëllim zbatimin e këtij procesi të rëndësishëm, është miratuar Vendimi nr. 197 datë 11.04.2018, i cili ndryshon Vendimin nr. 584 datë 28.08.2003 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave”. Nëpërmjet këtyre ndryshimeve, ndër të tjera, parashikohet detyrimi për kryerjen e vlerësimit të ndikimit gjatë procesit të politikëbërjes/hartimit të legjislacionit.

14 Me qëllim zbatimin e këtij procesi të rëndësishëm, është miratuar Vendimi nr. 197 datë 11.04.2018, i cili ndryshon Vendimin nr. 584 datë 28.08.2003 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave”. Nëpërmjet këtyre ndryshimeve, ndër të tjera, parashikohet detyrimi për kryerjen e vlerësimit të ndikimit gjatë procesit të politikëbërjes/hartimit të legjislacionit.

15 Sistemi i Planifikimit të Integruar të Menaxhimit të Informacionit

16 Sistemi i Menaxhimit Financiar

17 Sistemi i Menaxhimit të Asistencës së Huaj

(RENjK) tashmë është ngritur dhe është i aksesueshëm për publikun. Pas riorganizimit strukturor të administratës qendrore, janë përcaktuar qartë edhe *përgjegjësitë institucionale sa i takon procesit të monitorimit të konsultimit publik*, duke vendosur përgjegjësinë brenda aparatit të Kryeministrisë. Për vitin 2017, ndër 33 akte ligjore nga Këshilli i Ministrave (7 Strategji/Plane Veprimi dhe 26 projektligje), 29 prej tyre i janë nënshtruar procesit të Konsultimit Publik. Gjatë vitit 2018 do t'i kushtohet *vëmendje e veçantë përmirësimit të cilësisë së procesit të konsultimit publik*, nëpërmjet mekanizmave që sigurojnë reflektimin në politikat publike të kontributit të qytetarëve dhe grupeve të interesit. Parashikohet të hartoher një udhëzues metodologjik për zhvillimin dhe monitorimin e procesit të konsultimit publik.

Ecuri ka patur edhe nën Shtyllën II, e cila synon përmirësimin e mënyrës së organizimit dhe funksionimit të administratës publike, *përmes një procesi rrënjosor të ri-ndërtimit të mënyrës sesi ofrohen shërbimet për qytetarët, me një përqasje gjithëpërfshirëse dhe të qendëruar tek qytetari*.

Gjatë vitit 2017, janë hapur *tre qendra të integruara të ofrimit të shërbimeve në Krujë, Fier dhe Gjirokastër* të cilat mbulojnë shërbimet e ADISA për rreth 209,142 qytetarë dhe biznese. *Është krijuar sistemi i menaxhimit të ankesave si një mekanizëm për menaxhimin e ankesave të paraqitura nga qytetarët* në Qendrat e Integruarë ADISA.

Me synim rritjen e eficencës dhe efektivitetit të administratës qendrore si dhe adresimit të problematikave të identikuara në 4 vjeçarin e parë të qeverisjes, gjatë gjysmës së dytë së vitit 2017, nisi ristrukturimi i ministrive të linjës. Ky ristrukturim mundëson integrimin e ekspertit qeverisës horizontalisht dhe vertikalish, në një sistem të mirëintegruar të qeverisjes. Një qasje e njëjtë do të ndiqet edhe për institucionet e varësisë dhe agjencitë me qëllim përmirësimin e mënyrës së organizimit të administratës dhe përmirësimin e mëtejshëm të mënyrës së ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarëve dhe biznesit, duke eliminuar mbivendosjet në funksionet e këtyre institucioneve.

Në të gjitha institucionet e administratës shtetërore ka vijuar puna për garantimin e zbatimit rigoroz të legjislacionit për nëpunësin civil. Rol kryesor në këtë proces kanë patur Drejtoritë e Burimeve Njerëzore me qëllim ndërgjegjësimin e punonjësve për: njojjen, unifikimin dhe mbikëqyrjen e të gjitha procedurave për përmirësimin e performancës së administratës publike.

Ka vijuar më tej përmirësimi i procesit të rekrutimit dhe plotësimit të nevojave institucionale. Gjatë vitit 2017, janë ndërmarrë një sërë masash në drejtim të pasurimit dhe përmirësimit cilësor të bankës së pyetjeve për proceset e rekrutimit në shërbimin civil; përgatitjes së një sërë materialesh orientuese për t'i ardhur në ndihmë të gjithë aplikantëve potencialë (video-tutorial mbi mënyrën e aplikimit, dokument shpjegues mbi pyetjet më të shpeshta, etj); trajnimit të anëtarëve të Komiteteve të Përherëshme të Pranimit mbi metodologjinë dhe teknikat e sakta të vlerësimit të kandidatëve; bashkëpunimit me institucionet e arsimit të lartë me qëllim informimin e kandidatëve

potencialë (studentët dhe të sapodiplomuarit), lidhur me mundësitë e punësimit në administratën shtetërore, etj.

Gjatë vitit 2017 janë hedhur *hapa konkrete drejt mundësimit të gjenerimit të pagave të punonjësve të administratës nëpërmjet HRMIS*, proces ky i cili po pilotohet në 30 institucine shtetërore. *Gjithashtu, Sistemi Informatik i Manaxhimit të Burimeve Njerëzore (HRMIS) është pasuruar më tej më të dhëna nga institucionet e administratës publike*, institucionet e pavarura dhe njësitet e qeverisjes vendore, duke bërë të mundur që të hidhen në sistem mbi 550 institucionë dhe informacion për mbi 45,000 të punësuar. Ndërsa tjetra, janë trajnuar punonjësit e burimeve njerëzore si dhe financës si përdorues të Sistemit Informatik të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (HRMIS).

Ecuri e mirë është bërë në drejtim të përmirësimit të procedurave administrative dhe mbikëqyrjes, ku prioritet mbetet rishikimi i procedurave për ofrimin e shërbimeve ndaj publikut dhe thjeshtimin e tyre, duke përfshirë zgjidhje TIK në rastet kur është e mundur. Aktualisht, portali qeveritar e-Albania ofron 535 shërbime elektronike, dhe 47 sisteme shtetërore bashkëveprojnë me njëra-tjetrën për të garantuar komunikim në kohë reale mes qytetarit dhe institucioneve publike. *Për herë të parë, administrata publike bashkërendon gjenerimin e 29 dokumenteve me vullë dixhitale*.

IV. Progresi i zbatimit të reformave në kuadër të secilit prioritet


Shtylla I: Politikëbërja dhe Cilësia e Legjislacionit

Objektivat kryesore fokusohen në:


- ❖ Përmirësimin e planifikimit e koordinimit të politikave për të hartuar dokumenta strategjikë të qeverisë që i shndërrojnë prioritetet në veprime konkrete;
- ❖ Zbatimin e një sistemi transparent e gjithëpërfshirës të hartimit të ligjeve, i bazuar në politika dhe që siguron përafrimin me acquis;
- ❖ Ndërtimin e një sistemi monitorimi dhe vlerësimi efikas të strategjive, programeve dhe kuadrit ligjor në fuqi, të mbështetur në: (i) mbledhjen e të dhënave, nëpërmjet një procesi asnjëanës dhe transparent, për hartimin dhe zbatimin e strategjive, programeve dhe legjislacionit, si dhe (ii) në hartimin e analizave për vlerësimin e efekteve të krijuara nga zbatimi i politikave.

Krahasuar me vitin 2016, përgjatë vitit 2017, nën Shtyllën 1 “Politikëbërja dhe Cilësia e Legjislacionit” kanë filluar zbatimin dhe 2 produkte të reja (duke e çuar numrin total të produkteve në 25) si dhe janë realizuar plotësisht edhe 5 produkte të reja (duke e çuar numrin total të produkteve në 13).

Grafiku 6. Numri i produkteve në zbatim sipas Objektivave



Grafiku 7. Statusi i realizimit të produkteve sipas Objektivave



Progresi kundrejt secilit objektiv

Nga 13 produkte të parashikuara nën **Objektivin 1 “Politikat planifikuese dhe koordinuese të përmirësuara për të hartuar dokumenta strategjikë të qeverisë që i shndërrojnë prioritetet në veprime konkrete”** pjesa më e madhe e tyre (11) kanë filluar tashmë zbatimin dhe 6 janë realizuar

plotësisht deri në fund të vitit 2017, krahasimisht me 3 aktivitete që ishin realizuar plotësisht në 2016.

Progres është arritur në drejtim të zhvillimit të mëtejshëm të kuadrit strategjik. Përmirësimi i planifikimit e koordinimit të politikave lidhet ngushtësisht me zbatimin e Sistemit të Planifikimit të Integruar, përmes së cilës Qeveria synon të harmonizojë kuadrin strategjik/prioritetet strategjike me planifikimin financiar afatmesëm, duke përcaktuar në terma të përgjithshëm, rolin, statusin dhe hierarkinë e planifikimit strategjik.

Për vitin 2017 janë miratuar **7 dokumenta strategjikë sektoriale nga Qeveria Shqiptare, duke plotësuar dhe harmonizuar kornizën kuadër strategjike të SPI-së¹⁸**. Në kuadër të konsolidimit të kornizës kuadër strategjike për vitin 2017 janë miratuar:

- *Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2017-2020;*
- *Programi i Reformave Ekonomike 2018-2020;*
- *Strategjia Afatmesme e Menaxhimit të Borxhit 2018-2020;*
- *Programi i Statistikave Zyrtare 2017-2021;*
- *Strategjia Kombëtare Sektoriale e Shëndetësisë;*
- *Strategjia për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin 2017-2022;*
- *Plani i Veprimit kundër Kultivimit dhe Trafikimit të Kanabisit 2017-2020.*

Më specifisht deri në dhjetor të vitit 2017, janë miratuar 26 strategji pjesë të SKZHI II, ndërsa 3 dokumentat strategjikë janë në fazën e hartimit. Gjithashtu, janë miratuar 40% e dokumentave strategjike të planifikuara në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE), ndërsa 60% e dokumentave të planifikuara janë akoma në fazën e hartimit.

Cilësia e kuadrit strategjik sektorial dhe ndërsektorial si dhe harmonizimi me planifikimin buxhetor afatmesëm është përmirësuar gjatë tre viteve të fundit duke shënuar rritje me 3%. Bazuar në Raportin SIGMA 2017, harmonizimi mes kostove të planifikuara në strategjitet sektoriale dhe kostot e parashikuara në Planifikimin Buxhetor Afatmesëm vlerësohet në 56% kundrejt 53% në vlerësimin e OECD/SIGMA 2015.


Për të siguruar përputhjen e kornizës strategjike me programin buxhetor afatmesëm, janë zhvilluar seancat e negociatave nga Ministria e Financave, bazuar në kalendarin e PBA-së¹⁹. Në këtë proces, Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes ka analizuar 41 programe të PBA-së, të cilat mbulojnë rrëth 32% të programeve të përgjithshme që zbatojnë kuadrin strategjik (SKZHI II dhe strategjitet sektoriale dhe/ose ndërsektoriale).

Indikatori 1a.	Vlera 2017
100% e kuadrit strategjik rregulator i hartuar dhe i zbatuar	35%

¹⁸ Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 (SKZHI-II), si një komponent kyç i Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI), pasqyron vizionin, priorititet, objektivat dhe mjetet për zhvillimin social dhe ekonomik dhe aspiratat për Integrimin Evropian të vendit deri në vitin 2020.

¹⁹ Me pjesëmarrjen e Departamentit të Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes dhe Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme gjatë periudhës maj-qershor 2017, me ministritë e linjës dhe institucionet e tjera buxhetore.

Bazuar në të dhënat në dispozicion për vitin 2017 janë parashikuar të hartohen dhe miratohen 20 dokumente pjesë të KRS. Nga analiza rezulton që gjatë vitit 2017 janë miratuar 7 dokumente pjesë të KRS. Për sa më sipër rezulton se raporti i kuadrit strategjik të hartuar për 2017 është 35%



Indikatori 1b.

Vlera 2017

“100% e strategjive dhe e cilësisë sektoriale e përfunduar” (me llogaritjen e kostos së planit të veprimit dhe grupin e indikatorëve me objektivat përkatës) 100%

Përsa i takon indikatorit 1b “100% e strategjive dhe e cilësisë sektoriale e përfunduar” për vitin 2017 ky indikator është arritur në 100%, krahasuar me 85,7% në vitin 2016 dhe 70% në vitin 2015.

Gjatë vitit 2017 janë hartuar 2 Strategji: “Strategja Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin 2017 – 2022” dhe “Strategja Kombëtare e Shëndetësisë 2016 – 2020”. Të dyja këto Strategji janë hartuar në përputhje me Urdhrin e Kryeministrat për hartimin e dokumentit strategjik.

Në drejtim të menaxhimit të integruar të politikave, gjatë vitit 2017, u krye rishikimi afatmesëm i Dokumentit Strategjik të Shtetit (ICSP 2017-2020) me synim identifikimin e politikave dhe masave prioritare. Ky proces u bashkërendua nga Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme dhe Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes së bashku me ministritë e linjës.

Analiza e zhvilluar në këtë aspekt trajtoi dhe mori në konisderatë elementë që lidhen me:

- i. Zhvillimet në kuadrin e politikës së zgjerimit;
- ii. Zhvillimet e përfituesve IPA II;
- iii. Ndryshime të rëndësishme në gjendjen e përgjithshme të përfituesve të IPA II (ndryshime institucionale ose politike);
- iv. Ndryshimet e politikave që mund të ndikojnë në priorititetet e ndihmës financiare siç përcaktohet në Dokumentet e Strategjisë;
- v. Rishikime të politikave/strategjive sektoriale (duke përfshirë sektorët që nuk janë adresuar deri më tani) që do të kërkonin më shumë vëmendje sesa është dhënë aktualisht në kontekstin e programimit;
- vi. Zhvillimet në lidhje me kushtet e zbatimit (menaxhimi i tërthortë nga përfituesit).

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2017, u konsultuan rreth 43 masa prioritare, që lidhen kryesisht me përgatitjen e reformave në kuadër të Demokracisë, Sundimit të Ligjit dhe Çështjeve të brendshme, të fokusuara kryesisht në dy shtylla:

- a. Politikat e zhvillimit të orientuara për sektorin e mjedisit dhe sektorin e konkurrencës dhe inovacionit;
- b. Politikat sociale të orientuara për sektorin e punësimit, arsimit, promovimit ‘gender mainstreaming’ dhe zhvillimit të kapitalit njerëzor.

Në kuadër të forcimit të qasjes sistemike dhe një sistemi të integruar të qeverisjes, gjatë vitit 2017 është arritur dukshëm progres për finalizimin e tre sistemeve të menaxhimit të informacionit: IPSIS²⁰, AFMIS²¹ dhe EAMIS²². Zbatimi i këtyre tre sistemeve mbështet drejtëpërdrejtë modernizimin e administratës publike dhe zbatimin e parimeve të qeverisjes së mirë, të cilat pavarësisht natyrës komplekse janë dizenjuar për të funksionuar si një sistem i vetëm (*One Single System OSS*). Duke operuar si një i vetëm (OSS), krijohen kushtet për një qasje sistematike dhe të orientuar drejt performancës, planifikim efikas të politikave, të përputhura me programet buxhetore, si dhe raportim dhe monitorim i rezultateve dhe performancës për treguesit kryesorë.

Objektivat madhore të sistemit/One Single System (IPSiS, AFMIS dhe EAMIS) konsistojnë me:

- i. Menaxhimin e orientuar nga Performance & Rezultatet përmes treguesve të vlerësimit;
- ii. Rritjen e cilësisë së Mirëqeverisjes, Llogaridhënieve & Transparencës;
- iii. Krijimin e një sistemi fleksibel raportimi shumë-dimensional.

Hapa të rëndësishme institucionale janë ndërmarrë në drejtim të reflektimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm në politikat kombëtare (“Akhenda 2030 për zhvillim të qendrueshëm e Kombeve të Bashkuara “Të transformojmë botën tonë” dhe harmonizimi e kombëtarizimi i tyre”). Në vitin 2017 është krijuar Komiteti Ndërministror i Nivelit të Lartë për zbatimin e OZHQ, i kryesuar nga Zëvendëskryeministri dhe është mbajtur një takim i këtij Komiteti. Gjithashtu, është krijuar grupi teknik i punës për hartimin e Raportit dhe Udhërrëfyesit për OZHQ²³.

Gjatë vitit 2017 është përgatitur një vlerësim i parë mbi nivelin e harmonizimit të OZHQ me kornizën strategjike të vendit. Ky vlerësim tregon se:

- 33% e treguesve nga kuadri tregues global janë në harmonizim me treguesit kombëtarë;
- 24% e treguesve nga kuadri tregues global janë në harmonizim të pjesëshëm me treguesit kombëtarë;
- 43% e treguesve nga kuadri tregues global nuk janë të disponueshëm me treguesit kombëtarë;
- 7% e treguesve nga kuadri tregues global nuk janë të zbatueshme për vendin.

²⁰ Sistemi i Planifikimit të Integruar të Menaxhimit të Informacionit

²¹ Sistemi i Menaxhimit Financiar

²² Sistemi i Menaxhimit të Asistencës së Huaj

²³ Në shtator 2015, në takimin e Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), Qeveria e Shqipërisë, së bashku me 192 vendet anëtare të OKB-së, është angazhuar për zbatimin e Axfordës 2015-2030 për zhvillim të qëndrueshëm, nëpërmjet miratimit të deklaratës së përbashkët. Akhenda për zhvillim të qëndrueshëm është shumë komplekse. Ajo përbëhet nga 17 Objektiva të Zhvillimit të Qendrueshëm (OZHQ/SDG) dhe 169 synime (targets), objektiva të veçanta (targets), duke mbuluar të gjitha dimensionet kryesore të zhvillimit: (I) Dimensioni ekonomik, (II) Dimensioni social, dhe (III) Dimensioni i mjedisit.

Disponueshmëria e treguesve globalë për objektivat e OZHQS rezulton se:

- Numri i synimeve të OZHQ me të paktën një tregues të disponueshëm në Shqipëri 62 (ose 37%);
- Numri i objektivave të OZHQ me të paktën një tregues të disponueshëm me përpjekje në Shqipëri 13 (ose 8%);
- Numri i objektivave të OZHQ me të paktën një tregues pjesërisht të disponueshëm në Shqipëri 17 (ose 10%);
- Numri i objektivave të OZHQ pa indikatorë në dispozicion në Shqipëri 77 (ose 46%).

Deri në fund të vitit 2017 është finalizuar Raporti mbi Harmonizimin e OZHQ me objektivat e strategjive dhe politikave ekzistuese përvendin.


Gjithashtu gjatë vitit 2017, **një rëndësi e veçantë i është kushtuar ngritjes dhe forcimit të kapaciteteve për planifikimin strategjik**. Në këtë kuadër, janë hartuar kurrikulat si dhe janë zhvilluar cikle/paketa trajnimesh nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA) lidhur me hartimin dhe monitorimin e kuadrit strategjik & strategjive sektoriale/ndërsektoriale (sipas metodologjisë ekzistuese). **Janë trajnuar 54 nëpunës të shërbimit civil (NC), për kuadrin strategjik dhe 20% NC për Programin Buxhetor Afatmesëm.**

Indikatori 1c.

Vlera 2017

70% e stafit të politikë-bërjes të ML-së i trajnuar, të paktën, një herë për çështjet e planifikimit strategjik	49%
---	-----

70% e stafit të politikë-bërjes të ML-së i trajnuar, të paktën, një herë për çështjet e planifikimit strategjik



Indikatori i mësipërm ka shënuar rritje në vitin 2017 përsa i përket stafit të politikëbërjes të trajnuar, duke e çuar këtë shifër në 49%, krahasimisht me 33,6% që ishte në vitin 2016.

Objektivi 2 "Sistem transparent e gjithëpërfshirës i hartimit të ligjeve, i bazuar në politika dhe që siguron përafrimin me acquis" përmban gjithsej 12 produkte (6 prej tyre janë realizuar plotësisht krahasimisht me 4 në vitin 2016 dhe 3 janë nën zbatim).

Janë ndërmarrë tashmë hapat e nevojshme për të zbatuar Sistemin e Vlerësimit të Ndikimit. Vlerësimi i Ndikimit dhe procesi që ndiqet për zbatimin e këtij instrumenti të rëndësishëm, synon përmirësimin cilësor të praktikave të zhvillimit të politikave, si dhe kryerjen e analizave më të thelluara të akteve ligjore, para miratimit të tyre. Procesi i Vlerësimit të Ndikimit i cili do të

ndikojë në të gjitha institucionet e përfshira në procesin e hartimit të legjislacionit, do të ndihmojë gjithashtu në rritjen e transparencës dhe në përmirësimin e cilësisë së hartimit të legjislacionit. Me qëllim përmirësimin e procesit të kryerjes së vlerësimeve të impaktit, nëpërmjet mbështetjes së ofruar nga ekspertët e OECD/SIGMA, gjatë vitit 2017, ky proces ka vijuar me miratimin e versionit të parë të **Metodologjisë për Vlerësimin e Ndikimit** dhe më pas me pilotimin e zbatimit të kësaj Metodologjie. Më konkretisht, nëpërmjet Urdhrit të Kryeministrat nr. 102, datë 14.06.2017, “*Për ngritjen e grupeve të punës për pilotimin e zbatimin e Metodologjisë së Vlerësimit të Ndikimit, në disa ministri*”, të ndryshuar me Urdhrin nr. 194 datë 09.11.2017 “ Për disa ndryshime në Urdhrin nr. 102, datë 14.06.2017 të Kryeministrat, janë iniciuar **dy procese pilot**²⁴ të zbatimit të versionit të parë të metodologjisë së Vlerësimit të Ndikimit, si dhe kanë vijuar takimet trajnuese nga ekspertët ndërkombëtarë të OECD /SIGMA, për të përbyllur fazën e pilotimit të zbatimit të Metodologjisë për Vlerësimin e Ndikimit.

Jemi të ndërgjegjshëm se zhvillimi dhe koordinimi i politikave në përgjithësi, e më specifisht përkthimi i tyre në akte ligjore, haset me shumë sfidat. Duke qene një ushtrim kompleks, nuk mund të realizohet në kohë dhe me cilësi, pa patur struktura brenda qeverisë dhe kapacitete njerëzore që e garantojnë atë, duke përbushur funksionet për një sistem të organizuar mirë, me baza të qëndrueshme e afatgjata të politikëbërges. Për këtë qëllim, nëpërmjet strukturave të reja organizative të miratuara në tetor të vitit 2017, ministritë tashmë kanë një **njësi të dedikuar për monitorimin e vlerësimit të ndikimit**. Koordinimi i procesit të vlerësimit realizohet nga Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë, në Kryeministri.

Është arritur progres në plotësimin e mekanizmave ligjore e insitucionale që sigurojnë pjesëmarrjen e publikut në konsultimin e politikave publike. Pas miratimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 848, datë 7.10.2015 “Për miratimin e Rregullave të Krijimit dhe Administrimit të Regjistrat Elektronik për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, u ngrit që në Tetor të vitit 2016, Regjistri Elektronik për Njoftimin dhe Konsultimin Publik (RENjK) i cili është i aksesueshëm për të gjithë nëpërmjet faqes zyrtare www.konsultimipublik.gov.al.

Me prezantimin e sistemit elektronik, është bërë i mundur përdorimi i një instrumenti të rëndësishëm për realizimin e procesit të konsultimit publik në përputhje me standardet që kërkon ligji nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”. Për vitin 2017 janë miratuar 33 akte ligjore nga Këshilli i Ministrave (7 Strategji/Plane Veprimi dhe 26 projektligje), nga këto akte 29 i janë nënshtuar procesit të konsultimit publik.

Ministratë kanë realizuar në masën 87% për vitin 2017 objektivin e tyre të konsultimit të këtyre ligjeve. Cilësia e procesit të konsultimit publik vlerësohet në nivelin 5.15 pikë. Shënohet ulje si në përqindjen e ligjeve të konsultuara si në cilësinë e procesit të konsultimit. Me qëllim adresimin e këtij problemi, qeveria do të marrë masa përpërmirësimin e cilësisë së procesit të konsultimit publik, nëpërmjet mekanizmave që sigurojnë reflektimin në politikat publike të kontributit të

²⁴ Ministria e Financave dhe Ekonomisë në hartimin e projekt-ligjit të “Nxitjes së Punësimit”; Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në hartimin e projekt-ligjit të “Nxitjen e prodhimit, transportit, tregtisë dhe përdorimit të energjisë nga burimet e rinnovueshme”.

qytetarëve dhe grupeve të interesit. Parashikohet të hartohej një udhëzues metodologjik për zhvillimin dhe monitorimin e procesit të konsultimit publik.

Indikatori 1d. Bazuar në Raportin e Forumit Ekonomik Botëror 2017-2018 mbi “Konkurueshmërinë Globale” vlera e Indeksit për Transparencën në Politikbërje për Shqipërinë është 4.7 nga 5 targeti i synuar.

<i>Indikatori 1d.</i>	Vlera 2017
Përmirësimi i Indeksit të Transparencës gjatë procesit të politikbërjes nga ana e Qeverisë, sipas Forumit Ekonomik Botëror	4,7

Indikatori 2 a. Matja e këtij indikatori është objekt i veprimtarisë së Departamentit Rregulator dhe të Përputhshmërisë dhe do të mbështetet në metodologjinë e përshkruar në pasaportën e këtij indikatori, **duke filluar nga viti 2019**. Për vitin 2017, ky tregues shënon arritje në miratimin e metodologjisë RIA dhe kryerjen e dy pilotimeve të Analizave te Ndkimit, të cilat janë realizuar me sukses.

<i>Indikatori 2a.</i>	Vlera 2017
Cilësia e analizës së vlerësimit të ndikimit dhe vlerësimi i zbatimit aktet ligjore të rëndësishme të hartuara dhe të publikuara	Duke filluar nga viti 2019

Krahasuar me vitin 2016 vërehet një trend konstant në nivelin e ligeve që kanë kaluar në konsultim publik (87% në 2016) dhe një trend në ulje për indikatorin e cilësisë së konsultimit (6.17 në 2016).

<i>Indikatori 2b.</i>	Vlera 2017
Përqindja e akteve ligjore, të cilat kanë kaluar përmes një procesi të gjerë konsultimesh publike dhe provat e përfshirjes së publikut dhe palëve të interesuara në proces	87%

Indikatori 2c. Gjatë vitit 2017 Departamenti Rregulator dhe i Përputhshmërisë ka monitoruar ndryshimet e legjislacionit brenda harkut kohor të 12 muajve nga miratimi i projekt-ligjit bazë apo i ndryshimit më të fundit të tij. Të dhënët e procesit të monitorimit tregojnë se në 88 projekt-ligje të cilat janë miratuar në vitin 2017, **8 prej tyre kanë pësuar ndryshime brenda harkut kohor të 12 muajve nga miratimi i vetë ligjit apo i ndryshimit më të fundit të tij.**

<i>Indikatori 2c.</i>	Vlera 2017
Numri i akteve ligjore të ndryshuara brenda vitit të parë të miratimit	8

Objektivi 3 “Ndërtimi i një sistemi monitorimi dhe vlerësimi efikas të strategjive, programeve dhe kuadrit ligjor në fuqi, të mbështetur në: 1) mbledhjen e të dhënavë, nëpërmjet një procesi

asnjëanes dhe transparent, për hartimin dhe zbatimin e strategjive, programeve dhe legjislacionit, si dhe 2) në hartimin e analizave për vlerësimin e efekteve të krijuara nga zbatimi”.

Monitorimi i zbatimit të strategjive është një proces shumë i rëndësishëm i cili siguron jo vetëm rritjen e përgjegjshmërisë dhe forcimin e llogaridhëniec lidhur me arritjen e masave dhe objektivave të caktuara në secilën strategji të aprovuar nga qeveria, por mbi të gjitha është edhe një proces që ndihmon vendimarrësit në pasqyrimin e qartë të ecurisë së zbatimit të reformave të ndryshme sektoriale, evidentimin në kohë të problematikave të ndryshme që mund të shoqërojnë procesin e zbatimit të strategjive. Aktualisht ekziston një sistem i monitorimit të SKZHI-së, ndërkokë është finalizuar paketa e kuadrit metodologjik për monitorimin e strategjive, me mbështetjen e OECD/SIGMA²⁵.

Në këtë drejtim zbatimi i kuadrit të monitorimit për vitin 2017 u konceptua në disa fazë, nga ku faza e parë parashikonte hartimin e raporteve të monitorimit për kuadrin strategjik primar, të mbështetur nga IPA (përmes mbështetjes buxhetore), me qëllim për të vlerësuar:

- i. Arritjen e objektivave dhe rezultateve (treguesve të performancës) të strategjive sektoriale dhe/ose ndërsektoriale që monitorohen dhe raportohen në baza vjetore. Për çdo strategji (nga 7 strategjite e fazuara si pilot) u hartua një Raport Vjetor i Progresit për të paraqitur rezultatet e arritura;
- ii. Për Planin e Veprimit u përgatiten dy raporte të monitorimit: rapporti 6 mujor dhe rapporti vjetor.

Aktualisht, Strategjia e Ndërsektoriale e Reformës për Administratën Publike dhe Strategjia e Financave Publike (PFM) kanë zbatuar plotësisht metodologjinë e re, duke përfshirë pasaportat e treguesve dhe raportet vjetore dhe gjashtëmuajore të monitorimit.

Situata aktuale për 5 strategjite pilote është si vijon:

1. “Strategja Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014-2020” - janë përgatitur pasaportat e treguesve dhe raporti i monitorimit sipas metodologjisë.
2. “Strategja Ndërsektoriale të Mbrojtjes së Konsumatorëve dhe Mbikëqyrjes së Tregut 2014-2020” – po përgatiten pasaportat e treguesve (bazuar në metodologjinë e re).
3. “Strategja Ndërsektoriale kundër Korruptionit 2015-2020” - janë përgatitur pasaportat e treguesve (bazuar në metodologjinë e re) të cilat aktualisht janë duke u rishikuar dhe janë shqyrtuar.
4. “Strategja për Transportin” - ka progres në aspektin e monitorimit dhe gjatë vitit 2017 hartozi një draft të parë të raportit të monitorimit.
5. “Strategja e Drejtësisë” ka ngritur një strukturë të dedikuar për monitorimin e strategjive po hartojnë pasaportat e treguesve.


²⁵ Qëllimi i kuadrit të monitorimit dhe raportimit është sigurimi i monitorimit dhe raportimit për SKZHI-në, për strategjite sektoriale dhe ndërsektoriale si dhe dokumentet strategjike me qëllim harmonizimin me procesin e planifikimit buxhetor afatmesëm, proceset e negociatave të para-anëtarësimit si dhe me axhendën e reformave.

Indikatori 3a.

Vlera 2017

Përqindja e raporteve të monitorimit dhe vlerësimit për strategjitë e rëndësishme të hartuara dhe të publikuara në baza vjetore²⁶.

Përqindja e raporteve të monitorimit dhe vlerësimit për strategjitë e rëndësishme të hartuara dhe të publikuara në baza vjetore.




Janë hartuar raporte monitorimi edhe për Strategjinë e Pronësisë Intelektuale si edhe për Strategjinë e Reformës së Decentralizimit.

Indikatori 3b.

Vlera 2017

Shkalla në të cilën raportimi jep informacion mbi rezultatet e arritura (indikatori i SIGMA-s)

Shkalla në të cilën raportimi jep informacion mbi rezultatet e arritura(indikatori i SIGMA-s)



Nuk ka asnje ndryshim sa i takon vlerës së këtij indikatori, krahasimisht me vitin 2015.

Sipas Raportit të vlerësimit të OECD/SIGMA²⁷ “një sërë dokumentash dhe raportesh të hartuara nga administrata qendrore dhe institucionet e pavaruara nuk publikohen në faqet e internetit si dhe nuk ndiqet një standard i njëjtë për hartimin e tyre”.

Indikatori 3c.

Vlera 2017

Numri i konsultimeve publike/prezantimeve të organizuara për të diskutuar rapportet e monitorimit dhe vlerësimit.

Krahasuar më vitin 2015 që ka qenë edhe viti bazë, treguesi ka pësuar rritje me 1 pikë. Gjatë vitit 2017 janë hartuar dhe miratuar pas një procesi konsultimi 5 Raporte monitorimi. Më konkretilisht:

- Raporti mbi vlerësimin e ndërmjetëm (mid-term) i Strategjisë Ndërsektoriale Reforma e Administratës Publike 2015 – 2020 (Shtator 2017);
- Raporti 6 mujor për zbatimin e SNRAP 2015 – 2020 (Korrik 2017)

²⁶ Për illogaritjen e këtij indikatori janë marrë në konsideratë per vitin 2017 janë hartuar 7 Raporte M&V nga të cilët vetëm 3 janë botuar (SNRAP; PFM; Punësim; Transport; Decentralizim; Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Pronësia Intelektuale)

²⁷ Shih: Raporti I Vlerësimit “Parimet e Administratës Publike” fq 24

- Raporti 6 mujor për zbatimin e Strategjisë për Menaxhimin e Financave Publike (Korrik 2017);
- Raporti vjetor për zbatimin e Strategjisë Anti – Korrupsion (Korrik 2017);
- Raporti vjetor për zbatimin e Strategjisë së Decentralizimit (Tetor 2017)

Sfidat kryesore:

- Aktualisht, sistemi i SPI-së është në fazën e automatizimit të shtyllave kryesore të tij, që **konsiston në ngritjen dhe funksionimin e tre sistemeve MIS, të cilat do të funksionojnë si një “one-stop-shop” për menaxhimin e politikave & financave publike**, nga ana e administratës shtetërore. Të tre sistemet janë dizenuar si një Sistem i Vetëm i Integruar me shumë-përfitues, duke krijuar kushtet për të lidhur planifikimin-buxhetimin-ekzekutimin, për të pasur një informacion dhe monitorim në kohë reale të performancës.
- **Gjithashtu forcimi i paketës ligjore** me qëllim strandardizimin e shkallës hierarkike midis dokumentave strategjike dhe përputhshmërisë së kuadrit strategjik me planifikimin buxhetor afatmesëm përbën një tjetër dinamikë në këtë drejtim. **Përsa më sipër janë parashikuar masa lidhur me rishikimin e kornizës ligjore, krijimin e udhëzimeve/manualeve për kuadrin strategjik, përditësimin e udhëzimeve të monitorimit në përputhje dhe në koherencë me sistemet e menaxhimit** (dizanjet e sistemeve të aprovuara IPSIS & AFMIS).
- **Rritje e kapaciteteve teknike në nivel qendror** (mbështetje për përdoruesit e sistemeve në rritjen e kapaciteteve në fushën e menaxhimit të sistemit dhe proceseve që lidhen me planifikimin strategjik).


Shtylla II: Organizimi dhe Funksionimi i Administratës publike

Objektivat e planifikuara në kuadër të Shtyllës II synojnë:


- ❖ *Fuqizimin e strukturave të administratës publike me qëllim përmirësimin e ofrimit të shërbimeve ndaj publikut.*
- ❖ *Ofrimin e shërbimeve publike të përmirësuara, të aksesueshme, dhe të integruara duke reduktuar mundësitë për korrupsion dhe forcimin etikës në ofrimin e shërbimeve publike.*

Kjo shtyllë përbëhet nga 10 aktivitete, 7 prej të cilave kanë filluar të zbatohen dhe ku 6 prej tyre janë realizuar plotësisht deri në 2017 (grafiku 10), krahasimisht me 4 aktivitete të realizuara plotësisht në vitin 2016.

Grafiku 8. Numri i produkteve në zbatim sipas Objektivave



Grafiku 9. Statusi i realizimit të produkteve sipas Objektivave



Progresi kundrejt secilit objektiv

Në Objektivin 4 "Fuqizimi i strukturave të administratës publike për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve për publikun", kanë nisur të zbatohen 3 produkte nga 6 të parashikuara nën këtë objektiv si dhe janë realizuar plotësisht 3 prej tyre.

Gjatë gjysmës së dytë së vitit 2017, nisi ristrukturimi i ministrive të linjës, si një përgjigje ndaj nevojës që buron nga ndryshimet aktuale në formatimin e kabinetit qeveritar dhe fushat e reja të përgjegjësisë së tyre si rezultat i ndryshimit të portofoleve ministrore, problematikave të identifikuara në 4 vjeçarin e parë të qeverisjes dhe integrimit të ekspit qeverisës horizontalisht dhe vertikalisht, në një sistem të integruar qeverisës. Qëllimi i kësaj reforme është garantimi i një administratë publike mirëfunkSIONALE, transparente dhe eficiente, e aftë për t'ju përgjigjur nevojave të qytetarëve përsa i përket ofrimit të shërbimeve publike.

Parimet kryesore mbi të cilat është ndërtuar ky ristrukturim lidhen me nevojën për të qenë më të orientuar ndaj qytetarit, për të diferencuar funksionet politike dhe për të optimizuar shpërndarjen në territor. Qasja e ndjekur është e një natyre sistemike dhe të integruar.

Reforma e organizimit të brendshëm të aparatit të Kryeministrisë dhe ministrive të linjës, duke i vendosur ministritë në rolin e tyre udhëheqës në sektorin përkatës, duke bërë lehtësimin e aparatit të ministrive nga funksionet menaxheriale, operacionale, lëvrim shërbimesh, prokurime, dhënie licencash, zbatim projektesh, etj. duke i zbritur këto nëpër agjenci. Gjithashtu, filloi puna për reformimin e institucioneve të varësisë.

Si pjesë e zbatimit të reformës territoriale-administrative dhe fuqizimit të bashkive është dhënë mbështetje metodologjike për organizimin dhe funksionimin e Njësive Administrative me modelet e reja të organizimit. Deri në fund të vitit 2017 janë dhënë rekomandime për strukturat e reja në disa bashki dhe njësi administrative.

Indikatori 4a.	Vlera 2017
Shkalla në të cilën strukturat e ministrive dhe institucionet e tjera janë rationale dhe koherente (indikatori i SIGMA-s)	2

Ky tregues nuk ka pësuar ndryshim²⁸, pasi i referohet vlerësimit të OECD/SIGMA në fillimet e vitit 2017 dhe mbulon periudhën e vlerësimit 2015-2016, kohë gjatë së cilës administrata nuk pësoi ndryshime të ndjeshme nga pikëpamja e strukturave. Si rezultat treguesi nuk merr parasysh ndryshimet e ndodhura në strukturat e administratës pas zgjedhjeve parlamentare.

Gjatë vitit 2017, janë ngritur qendra të shërbimeve të integruara me një ndalesë në Tiranë, Kavajë, Krujë, Fier, Gjirokastër si dhe në vazhdim janë ngritur zyrat me një ndalesë në 11 bashki, (krahasimisht me 5 bashki që ishin në vitin 2016): Shkodër, Lezhë, Durrës, Elbasan, Korçë, Vau Dejës, Mat, Klos, Sarandë, Berat dhe Fier. Gjithashtu është duke përfunduar ngritja e qendrës në Bashkinë Roskovec. Në secilën prej bashkive janë zbatuar mbi 70 shërbime administrative si edhe është mundësuar përdorimi i sistemit edhe në NjA. Numri i shërbimeve të identifikuara pas funksioneve të reja që i kanë kaluar pushtetit vendor është rritur nga 67 në 109 shërbime të dixhitalizuara.

Në kuadër të mbështetjes përfunksionimin e NjQV dhe forcim të kapaciteteve zbatuese si dhe përhapja e praktikave më të mira ka qenë dhe do të vazhdojë të jetë një prioritet kyç përfunksionimin e administratës vendore. Do të vijojë të ofrohet asistencë përfundimtare zhvillime teknike dhe trajnime në vendin e punës për stafin e bashkive dhe njësive të tyre administrative përmirësimin e punës në mbledhjen e taksave; hartimin e metodave alternative përritjen e të ardhurave të veta; menaxhimin më të mirë të aseteve dhe rritjen e parashikueshmërisë, saktësisë dhe transparencës së proceseve buxhetore dhe menaxhimit financiar dhe kontrollit të qeverisjes

²⁸ Shih OECD/SIGMA Raporti Vlerësimit 2017 "Parimet e Administratës Publike" fq. 89-90

vendore. Asistencë e mëtejshme teknike do të ofrohet për ngritjen e kapaciteteve të bashkive për t'u shërbyer më mirë qytetarëve.

Sfida për vitin në vazhdim mbetet rishikimi funksional strukturor i institucioneve të varësisë dhe përcaktimi i rregullave dhe standardeve të qarta në fushën e ndërtimit të institucioneve dhe të matjes së performancës së tyre.


Në kuadër të Objektivit 5 "Shërbime publike të përmirësuara, të aksesueshme, dhe të integruara duke reduktuar mundësitë për korrupsion dhe forcimin etikës në ofrimin e shërbimeve publike", janë realizuar 3 nga 4 produktet e parashikuara (krahasimisht me 1 produkt të realizuar plotësisht në vitin 2016).

Në kuadër të krijimit të një modeli të ri për ofrimin e shërbimeve publike, janë ndarë Zyrat Pritëse nga Zyrat Përgjegjëse të Ofritmit të Shërbimit, si dhe janë ngritur Qendra të Integruar dhe shtrirjes territoriale në Republikën e Shqipërisë.

Gjatë vitit 2017 janë hapur Qendrat e Integruar ADISA Krujë, Fier dhe Gjirokastër ku ofrohen përkatësisht:

- 1) ***Qendra e Integruar ADISA Krujë - 229*** shërbime të **6** institucioneve në **14** sportele pritëse, përkatësisht FSDKSH, ZRPP, ISSH, DPGJC, DPT dhe QKB, për rreth **59,814 qytetarë dhe biznese** (shërbime të regjistrimit të pasurisë, sigurimet shoqërore, karta e shëndetit, regjistrimi i biznesit, gjendja civile dhe tatimet). Gjatë vitit 2017, totali i aplikimeve të kryera në sportelet pritëse është **31,603** aplikime, si dhe janë paraqitur në sportelin e informacionit **11,749** persona.
- 2) ***Qendrën e Integruar ADISA Fier - 339*** shërbime të **8** institucioneve të nivelit qendror dhe vendor në **23** sportele pritëse, përkatësisht FSDKSH, ZRPP, ISSH, DPT, QKB, SHKP, Taksa Vendore dhe Drejtoria e Regjistrimit të Tokave Bujqësore, për rreth **120,655 qytetarë dhe biznese** (shërbime të regjistrimit të pasurisë, sigurimet shoqërore, karta e shëndetit, regjistrimi i biznesit, shërbimet e punësimit, tatimet dhe taksat vendore, regjistrimi i tokave bujqësore). Gjatë vitit 2017, janë kryer **44,652** aplikime në sportelet pritëse si dhe janë paraqitur në sportelin e informacionit **16,266** persona.
- 3) ***Qendra e Integruar ADISA Gjirokastër -334*** shërbime të **6** institucioneve publike në **21** sportele pritëse, përkatësisht FSDKSH, ZRPP, ISSH, DPGJC, DPT dhe QKB, për rreth **28,673 qytetarë dhe biznese** (shërbime të regjistrimit të pasurisë, sigurimet shoqërore, karta e shëndetit, regjistrimi i biznesit, gjendja civile dhe tatimet). Gjatë vitit 2017, totali i aplikimeve të kryera në sportelet pritëse është **25,549** aplikime, si dhe janë paraqitur në sportelin e informacionit **5,664** persona.

Në grafikët e mëposhtëm tregohet numri i aplikimeve të kryera dhe kërkesave për informacion nga qytetarët të marra në sportelet pritëse ADISA në ZVRPP Tiranë dhe në Qendrat e Integruesa për ofrimin e shërbimit në Kavajë, Krujë, Fier dhe Gjirokastër:




Në zbatim të Memorandumit të Mirëkuptimit, Nr. 1013, datë 10.10.2017, lidhur ndërmjet DPT - ADISA – BERZH, është dakordësuar për ngritjen e një platforme informimi për tatimpaguesit në Shqipëri me theks të veçantë në informimin e bizneseve mikro, të vogla e të mesme mbi detyrimet dhe të drejtat që burojnë nga legjislacioni tatimor në Shqipëri.

Me qëllim rritjen e aksesit dhe informimin e qytetarëve për më shumë se **500** shërbime publike, ADISA ka krijuar aplikacionin “*ADISA Mobile App*” duke ofruar informacion të detajuar mbi Kartelat Informativë, si dhe të mundësojë rezervimin e biletës online për marrjen e shërbimit pranë sporteve të ADISA në ZVRPP Tiranë. Gjatë kësaj periudhe aplikacioni është hedhur në AppStore dhe Playstore, me qëllim testimin e funksionalitetit të tij.



Figura 1 - Ndërsaqja kryesore dhe modulet e aplikacionit mobile ADISA

Është shtuar numri i shërbimeve dhe institucioneve për të cilat ofrohet informacion nëpërmjet Kartelave Informative të përgatitura, duke shkuar në **496** shërbime të **17** institucioneve publike, që kanë të bëjnë me fusha të tillë si: prona, transporti, liçensimi, regjistri i gjendjes civile, regjistrimi i bizneseve, etj²⁹. Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2017 janë informuar rreth **4,088** qytetarë (ndër të cilët 4 nga 5 informohen plotësisht). Nga të dhënrat e monitoruara rezulton se numri i telefonatave të kryera nga meshkujt dhe nga femrat është afersisht i njëjtë, përkatësisht **47%** e telefonatave nga femrat dhe **53%** e telefonatave nga meshkujt. Pothuajse të gjitha telefonatat janë kryer nga zonat urbane, përkatësisht **98%** e telefonatave nga zonat urbane dhe **2%** nga zonat rurale. Qytetarët informohen më së shumti për Call Center ADISA nga kanalet online, përkatësisht **55%** e tyre. Ndërkohë 4 nga 10 qytetarë janë telefonues të rregullt.



Në të gjitha Qendrat e Integruara ADISA ka vodosur **standard të përmirësuar në lëvrimin e shërbimit, bazuar në parimet e kujdesit qytetar**, veçanërisht ato në lidhje me:

- Sigurimin e një mjedisi të përshtatshëm pune në Zyrat Pritëse dhe mundësimin e trajnimeve të vazhdueshme për personelin e këtyre Zyrave;
- Pajisjen e Qendrave me Një Ndalesë dhe Zyrës Pritëse Tiranë me sinjalistikën e nevojshme dhe lehtësira parkimi, përfshirë hapësira përfshirë fëmijë;
- Ngritjen e një Sistemi Menaxhimi Radhe dhe mundësimi ulëseve gjatë pritjes;
- Ngritjen e një Sistemi për Menaxhimin e Ankesave (SMA);
- Pajisjen me infrastrukturën e domosdoshme për t'u mundësuar akses njerëzve me aftësi të kufizuara (p.sh vodosja e rampave, tualete të dedikuar, etj.);
- Monitorimin e performancës në lëvrimin e shërbimit.


Sistemi i menaxhimit të ankesave është një rishi dhe një mekanizëm me anë të të cilit qytetarët mund të shprehin pakënaqësitë e tyre në lidhje me shërbimet e ofruara nga institucionet që ofrojnë shërbimet në sportelet pritëse ADISA, si: ZRPP, ISSH, FSDKSH, DPGJC, DPT etj

²⁹ përkatësisht: ABSA, ALUIZNI, AQTN, ATP, AZHT, DPB, DPD, DPGJC, DPP, DPSHTRR, DPT, FSDKSH, ISSH, MASR, MZHU, QKB, QSHA, SHSSH dhe ZRPP.

dhe/ose në lidhje me asistentët e shërbimit nën varësi të ADISA. Me anë të këtij sistemi bëhet i mundur regjistrimi dhe menaxhimi i ankesave të paraqitura nga qytetarët në Qendrat e Integrues ADISA. Me hapjen e tre qendrave të Integrues ADISA në Krujë, Fier dhe Gjirokastër, u bë i mundur që nëpërmjet këtij sistemi të ruhen të gjitha detajet kryesore të një ankesë, për të gjitha institucionet të cilat janë pjesë e këtyre Qendrave. Gjatë vitit 2017 janë depozituara **3,731** ankesa për ZVRPP Tiranë, **289** ankesa për institucionet në Qendrën e Integruar Kavajë, **20** ankesa për institucionet në Qendrën e Integruar Krujë, **740** ankesa për institucionet në Qendrën e Integruar Fier dhe **206** ankesa për institucionet në Qendrën e Integruar Gjirokastër.

Më poshtë paraqitja grafike e ankesave të depozituara në sportelin e ankesave për institucionet në FO ADISA ZVRPP Tiranë dhe në Qendrat e Integrues ADISA:

Grafiku 14 - Numri i ankesave të depozituara në sportelet pritëse ADISA



Me qëllim modernizimin dhe përmirësimin e shërbimeve publike nëpërmjet një qasje innovative dhe me në qendër qytetarin, zhvillimit të ideve të reja dhe zgjidhjeve të bazuara në nevojat e të gjithë qytetarëve dhe bizneseve në Shqipëri, me Urdhër Nr. 1118, datë 16.11.2017 “Për ngritjen e grupit të punës në kuadër të projektit ADISA Innovation Lab (ADISALab)”, u ngrit struktura e parë e këtij lloji në Republikën e Shqipërisë. Gjatë këtij viti, ADISALab ka zhvilluar aktivitetet si më poshtë:

- Krijimi i logos dhe hapja e website zyrtar të ADISALab, përkatësisht: - <http://lab.adisa.gov.al>;
- Organizimi i takimeve periodike me anëtarët e skuadrës dhe përcaktimi i objektivave për t'u realizuar, përkatësisht:
 - i. **Njësitë lëvizëse:** sjellja e shërbimeve publike më afër seilit dhe çdo qytetari, duke ofruar akses në shërbime për zonat rurale;
 - ii. **Aplikacioni ADISA Mobile:** sjellja e shërbimeve publike në dorën e qytetarëve, duke i ofruar qytetarëve informacion për shërbimet e ofruara dhe krijuar mundësisë për të rezervuar një biletë për shërbimet në qendrat tona – kudo dhe në çdo kohë.




Figura 2 - ADISA Innovation Lab

Indikatori 5a.

Vlera 2017

Numri i shërbimeve të qeverisë qëndrore me ndërveprim të përmirësuar në zyrat e pritjes




Vlera e indikatorit të mëposhtëm është 2-fishuar rritje pasi është shtuar numri i zyrave me një ndalesë të ngritura në njësitë e qeverisjes vendore, nga 5 të tilla në vitin 2016 në 11 bashki në vitin 2017.

Indikatori 5b.

Vlera 2017

Numri i zyrave me një ndalesë të ngritura në njësitë e qeverisjes vendore

11 bashki



Përpos arritjeve, gjatë 2017 ka patur edhe sfida sa i takon përmbushjes së këtij objektivi, më konkretisht:


- *Sfida buxhetore* - mungesë e fondeve të nevojshme për ngritjen e qendrave të integruara;
- *Sfida teknike* - vështirësi në gjetjen e ambjenteve të përshtatshme për ngritjen e qendrave;
- *Sfida legislative* - mosmiratimi i akteve ligjore dhe nënligjore për kalimin e sporteve të institucioneve në fokus, në administrim të ADISA.

Shtylla III “Shërbimi civil: Menaxhimi i Burimeve Njerëzore”

Objektivat e parashikuara synojnë:

- ❖ *Përmirësimin e kapaciteteve për zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil dhe procedura të lehtësuara për zbatim;*
- ❖ *Organizimin e sistemit të pagave në shërbimin civil duke u bazuar në vlerësimin e vendit të punës, të arritjeve vjetore të nëpunësve civilë dhe rezultateve në trajnimet e detyrueshme*

Siç paraqitet edhe në grafikët më poshtë në kuadër të kësaj shtylle kanë filluar të zbatohen 18 produkte nga 25 në total. Nga këto produkte që kanë nisur zbatimin, 14 prej tyre janë realizuar plotësisht.



Progresi kundrejt secilit objektiv

Objktivi 6: Kapacitete të përmirësuara për zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil dhe procedura të lehtësuara për zbatim. Nga 22 aktivitete 14 prej tyre janë realizuar plotësisht.

Përgjatë vitit 2017, në kontekstin e zbatimit të reformës në administratën publike, puna u fokusuar në:

- > *Vazhdimin e implementimit dhe garantimit të zbatimit rigoroz të legjislacionit për nëpunësin civil, në të gjitha institucionet e administratës shtetërore, nëpërmjet koordinimit me të gjitha njësitë e burimeve njerëzore për njohjen, unifikimin dhe mbikqyrjen e të gjitha procedurave përmirësimin e performancës së administratës publike;*

- > Reformën funksional – strukturore të institucioneve të administratës publike, me fokus të veçantë në ristrukturimin e aparatit të Kryeministrisë, ministrike të linjës dhe institucioneve të varësisë;
- > Përmirësimin e kuadrit rregullator;
- > Përmirësimin e procesit të përzgjedhjes dhe vlerësimit të kandidatëve që konkurojnë për t'u bërë pjesë e administratës shtetërore;
- > Forcimin e kapaciteteve të DAP dhe njësive të burimeve njerëzore në institucionet e administratës shtetërore, për të çuar përpara reformën në shërbimin civil, nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme për kuptimin e politikave të menaxhimit të burimeve njerëzore, ndërlidhjen dhe efektet e tyre;
- > Zhvillimin e mëtejshëm të metodave inovative për të përmirësuar dhe lehtësuar komunikimin dhe ndërveprimin mes institucioneve publike dhe qytetarëve;
- > Forcimin e vazhdueshëm të SPA si ofrues i trajnimeve për shërbimin civil;
- > Shtrirjen e SMIBNJ/HRMIS në institucionet e administratës shtetërore jo pjesë e shërbimit civil, institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore dhe Implementimi i modulit te pagave nëpërmjet SIMBNJ/HRMIS.

Më poshtë paraqiten arrijet konkrete kundrejt objektivave. **Me qëllim përmirësimin e procesit të rekrutimit dhe plotësimin e nevojave institucionale, Departamenti i Administratës Publike, gjatë vitit 2017, ndërmorri një sërë masash në drejtim të:**

- > Pasurimit dhe përmirësimit cilësor të pyetjeve në bankën e pyetjeve;
- > Përgatitjes së një sërë materialesh orientuese për t'i ardhur në ndihmë të gjithë aplikantëve potencialë (video-tutorial mbi mënyrën e aplikimit, dokument shpjegues mbi pyetjet më të shpeshta, etj);
- > Trajnimit të anëtarëve të Komiteteve të Përherëshme të Pranimit mbi metodologjinë dhe teknikat e sakta të vlerësimit të kandidatëve;
- > Bashkëpunimit me institucionet e arsimit të lartë me qëllim informimin e kandidatëve potencialë (studentët dhe të sapodiplomuarit), lidhur me mundësitë e punësimit në administratën shtetërore, etj³⁰.

Edhe gjatë vitit 2017 është punuar në drejtim të **përmirësimit të procesit të rekrutimit në shërbimin civil, në të gjitha etapat e tij**, duke nisur nga planifikimi i vendeve vakante, grupimi dhe shpallja e tyre, orientimi i publikut lidhur me mënyrën e saktë të aplikimit dhe menaxhimi i procesit të rekrutimit në mënyrë efektive, nëpërmjet implementimit të metodave inovative. Gjatë këtij viti për arsyet e zhvillimit të zgjedhjeve të përgjithshme politike e më pas të riformatimit të kabinetit qeveritar, Departamenti i Administratës Publike shpalli procedura rekrutimi vetëm për një periudhë 4 mujore. Si rezultat të gjitha të dhënat në lidhje me këtë proces

³⁰ Në datat 16-29 Maj 2017, përfaqësues të DAP në bashkëpunim me përfaqësuesit e Projektit të Binjakëzimit vizituan 17 fakultete në 6 qytete të Shqipërisë, ku prezantuan procesin e rekrutimit dhe mënyrën e aplikimit për 1500 studentët pjesëmarrës.

janë për një periudhë kohore më të shkurtër se sa vitet paraardhëse. u zhvilluan 242 procedura konkurrimi për 481 pozicione të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese. Numri mesatar i kandidatëve për një pozicion per vitin 2017 llogaritet të jetë 18. Siç mund të vihet re nga grafiku i mëposhtëm, numri mesatar i aplikantëve për pozicion ka pësuar rritje në krahasim me vitet e mëparshme, gjë që tregon për një interesim në rritje për t'u bërë pjesë e shërbimit civil.

Numri mesatar i aplikantëve për periudhën 2001 - 2017



Janë hedhur *hapa konkrete drejt mundësimit të gjenerimit të punonjësve të administratës nëpërmjet HRMIS*, proces ky i cili po pilotohet në 30 institucine shtetërore. *Gjithashtu, Sistemi Informatik i Manazhimit te Burimeve Njerëzore (HRMIS) është pasuar më tej më të dhëna nga institucionet e administratës publike*, institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore, duke bërë të mundur që të hidhen në sistem mbi 550 institucionë dhe informacion për mbi 45,000 të punësuar.

Gjithashtu, gjatë vitit 2017 janë trajnuar **mbi 270 nëpunës** të sektorëve të burimeve njerëzore përfshirë këtu dhe njësitë e qeverisjes vendore, si dhe njësitë e Drejtive Arsimore Rajonale dhe Zyraje Arsimore në të gjithë vendin, duke zhvilluar **mbi 30 seanca trajnimi** të fokusuar për strukturat, organikat dhe hedhjen e të dhënavë të dosjes individuale të të punësuarve.

U zhvillua dhe përmirësua moduli i pagave³¹ nëpërmjet Sistemit Informatik të Menazhimit të Burimeve Njerëzore (HRMIS) i cili *do të vendosë një standard të ri në llogaritjen e pagave të të gjithë punonjësve në administratën publike*. Sistemi i'u prezantua rrëth 350 punonjësve të sektorëve të financave në institucionë të ndryshme shtetërore. Gjatë 3 muajit të fundit të vitit 2017 filloj pilotimi dhe testimi i gjenerimit të pagës për grupin e parë të përbërë nga gati 30 institucionë të shërbimit civil dhe të pavarur.

U realizua për herë të parë vlerësimi i njohurive për nëpunësit civilë në pozicione me funksione inspektimi. Departamenti i Administratës Publike në kuadër të vlerësimit të kapaciteteve të

³² Në këtë program u përfshi:

- Qyteti i Tiranës: Fakultetit Ekonomik (400 studentë), Fakultetit i Shkencave Sociale (200 studentë), Fakultetit i Drejtësisë (200 studentë);
- Qyteti i Durrësit: Universiteti "Aleksandër Moisiu", Fakulteti i Biznesit, Fakulteti i Shkencave Politike - Jurdike (200 studentë);
- Qyteti i Vlorës: Universiteti "Ismail Qemali", Fakulteti i Ekonomisë, Fakulteti i Shkencave Teknikë;
- Qyteti i Shkodrës: Universiteti "Luigj Gurakuqi" (100 studentë);
- Qyteti i Korcej, Universiteti "Fan S Noli" (100 studentë);
- Qyteti i Elbasanit, Universiteti "Aleksandër Xhuvani" (200 studentë).

burimeve njerëzore në administratën publike zhvilloi procedurën e vlerësimit për përditësimin dhe përfitimin e njohurive shtesë për mbi **1,300** nepunës civilë në pozicione me funksione inspektimi. Procesi tregoi se kapacitetet në këtë fushë ishin mesatare dhe nxorri si nevojë rritjen e këtyre kapaciteteve nëpërmjet trajnimeve të dedikuara në këtë fushë.

Edhe gjatë vitit 2017, është punuar për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Gjithashtu, institucionet janë mbështetur nga Departamenti i Administratës Publike për një kuptueshmëri më të qartë të urdhrit nr. 5151/2015, e si rrjedhim të zbatimit rigoroz të rregullave dhe modaliteteve që duhen ndjekur nga institucionet e administratës shtetërore për zbatimin e këtyre vendimeve.

Si rezultat i punës së bërë, gjatë vitit 2017 janë zbatuar gjithsej 46 vendime gjyqësore të formës së prerë, duke shënuar një rritje prej 43.75%, krahasuar me vitin 2016 si dhe një rritje prej 31.3% i indikatorit të zbatimit të të gjitha vendimeve gjyqësore të mbartura që nga fundi i vitit 2013.

Për vitin 2017, vlen të përmendet fushata informuese dedikuar rritjes së informimit të publikut të gjerë mbi reformën në administratën publike dhe mundësítë konkrete të punësimit. Në datat 16-29 Maj 2017, përfaqësues të DAP në bashkëpunim me përfaqësuesit e Projektit të Binjakëzimit vizituan 17 fakultete në 6 qytete të Shqipërise³² ku prezantuan procesin e rekrutimit dhe mënyrën e aplikimit për 1500 studentët pjesëmarrës. Në këto takime u shpërndanë edhe një sërë materialesh informuese të përgatitura nga DAP dhe projekti³³



Krahas fushatës informuese në universitete të ndryshme të vendit, u krijua edhe një video shpjeguese mbi procesin e rekrutimit, si dhe një video mbi reformën në administratën publike dhe ndryshimet ndër vite për ta bërë procesin sa më të qartë për të gjithë qytetarët³⁴.

³² Në këtë program u përfshin:

-Qyteti i Tiranës: Fakultetit Ekonomik (400 studentë), Fakultetit i Shkencave Sociale (200 studentë), Fakultetit i Drejtësisë (200 studentë);

-Qyteti i Durrësit: Universiteti "Aleksandër Moisiu", Fakulteti i Biznesit, Fakulteti i Shkencave Politike - Jurdike (200 studentë);

-Qyteti i Vlorës: Universiteti "Ismail Qemali", Fakulteti i Ekonomisë, Fakulteti i Shkencave Teknike;

-Qyteti i Shkodrës: Universiteti "Luigi Gurakuqi" (100 studentë);

-Qyteti i Korce, Universiteti "Fan S Noli" (100 studentë);

-Qyteti i Elbasanit, Universiteti "Aleksandër Xhuvani" (200 studentë).

³³ Mbi 1500 fletëpalosje ku shpjegohet procesi i rekrutimit; Mbi 1500 fletëpalosje mbi rolin e Departamentit të Administratës Publike; Mbi 1200 fletëpalosje ku paraqiten profile e vendeve vakante të punës për vitin 2017.

³⁴ <https://www.youtube.com/watch?v=nTsYw7C4kg&t=4s>



Ndër të tjera, në bashkëpunim me projektin e binjakëzimit IPA 2012, “Mbështetje për reformën e shërbimit civil” u përgatitën një sërë udhëzimesh të rendësishme, katalogë të ndryshëm dhe manuale³⁵.



Gjithashtu, Departamenti i Administratës Publike përgatiti disa video tutoriale të cilat synojnë të shpjegojnë procedurat e aplikimit në shërbimin civil, me qëllim rritjen e transparencës ndaj publikut dhe vënien në dispozicion të materialeve dhe udhëzimeve të nevojshme për krijuar një llogari në faqen zyrtare të DAP, udhëzimet mbi ngarkimin e dokumentacioni dhe detajet e aplikimit³⁶.



³⁵ Materialet e prodhura mund të aksesohen nëpërmjet faqes zyrtare të Departamentit të Administratës Publike: <http://dap.gov.al/projekte/materialeper-nepunesin-civil>.

³⁶ <https://www.youtube.com/watch?v=IkD4DptuL18&t=22s>; <https://www.youtube.com/watch?v=VQk8XSTypQ>; <https://www.youtube.com/watch?v=IkD4DptuL18>; https://www.youtube.com/watch?v=g9TxlbuxA_Q



Ka vijuar bashkëpunimi mes Departamentit të Administratës Publike dhe Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i cili përgjatë periudhës raportuese ka realizuar procesin e mbikqyrjes për të gjitha procedurat e rekrutimit për vitin 2017 në nivel ekzekutiv, lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë.

Komisioneri e vlerëson në një nivel të mirë zbatimin e ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil bazuar në rezultatet ka mbikqyrur 12 institucionë qendrore të administratës shtetërore,³⁷. Në lidhje me nivelin e ekzekutimit të vendimeve të Komisionerit, rezulton se në institucionet për të cilat ka përfunduar procesi i verifikimit të zbatimit të vendimit paralajmëruar, në 58 raste (ose 88% të tyre) rekomandimet e Komisionerit janë zbatuar plotësisht (bëhet fjalë për 29 institucionë të administratës shtetërore (ose 50% të rasteve) dhe 29 njësi të qeverisjes vendore (ose 50% të rasteve)), dhe në 8 raste (ose 12% të tyre) rekomandimet e Komisionerit janë zbatuar pjesërisht (bëhet fjalë për 2 institucionë të administratës shtetërore (ose 25% të rasteve) dhe 6 njësi të qeverisjes vendore (ose 75% të rasteve)). Gjatë vitit 2017, vështirësitet apo sfidat e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për realizimin e objektivave kanë pasur të bëjnë me burimet e kufizuara njerëzore dhe logjistike.

Aktiviteti i ASPA gjatë vitit 2017 ka patur synimin kryesor përgatitjen e administratës publike shqiptare në sfidën e integrimit evropian dhe në zbatim të legjislacionit të shërbimit civil. Vitet e fundit është vënë re një përmirësim i vazhdueshëm i sistemit të trajnimit profesional në Shqipëri, si nga pikëpamja e përbajtjes në zhvillimin e kurrikulave cilësore ku janë përfshirë 104 module trajnimi, ashtu edhe në aspektin e zhvillimit dhe kontrollit të cilësisë së trajnimit. Si rezultat, viti 2017 shënoi një performancë më të lartë.

Treguesit mbi nëpunësit civilë të trajnuar, ditët e trajnimit, kurset e trajnimit

Numri ditëve të trajnimit për nëpunësit civilë, si dhe larmia e tematikave të trajnimit krahasuar me vitet e mëparshme, kanë shënuar rritje. Në këtë kontekst mund të përmendim që është ***thuajse dyfishuar sasia mesatare e orëve të trajnimit për nëpunës civil***, nga 25 orë në vitin 2016, në 40 orë trajnimi në vitin 2017.


³⁷ (Nga të cilat 11 Ministri të linjës dhe Kryeministria); 39 bashki dhe 220 ish komuna, tashmë Njësi Administrative, pjesë e strukturës së bashkisë, 1 Këshill Qarku; si dhe 25 institucionë varësie, ndër të cilat evidentohen 9 Drejtori Arsimore Rajonale (dhe 17 Zyra Arsimore); 5 Drejtori Bujqësie, 6 Prefektura të Qarkut dhe 5 institucionë të ndryshme varësie që në total përfshijnë 2,803 pozicione pune pjesë e shërbimit civil

Më konkretisht më poshtë paraqiten në formë tabelare treguesit në lidhje me numrin e nëpunësve civilë të trajnuar, ditëve dhe kurseve të trajnimit, për vitin 2017, si dhe në formë grafike të njëjtat të dhëna për efekt kahasimi për vitet 2013-2017.

Treguesit për vitin 2017:

Indikatori	Vlera 2017
Nëpunës civilë pjesëmarrës në trajnime	4.789
Kurse trajnimi	194
Ditë trajnimi	850
Nëpunës civilë për ditë trajnimi	21.072

Statistika të trajnimit për periudhën 2013 - 2017




Ndër nëpunësit civilë të trajnuar gjatë vitit 2017:


- 1 % i përkasin kategorisë së lartë drejtuese;
- 16 % i përkasin kategorisë së mesme drejtuese;
- 7 % i përkasin kategorisë së ulët drejtuese;
- 76 % i përkasin kategorisë ekzekutive.

Më poshtë paraqiten në mënyrë grafike, për efekt kahasimi, të dhënat e nëpunësve civilë të trajnuar të ndarë sipas kategorive të nëpunësve civilë, pra sipas grupeve të synuara, për: (i) vitin 2017 dhe për vitet 2014 – 2017. Të dhënat paraqiten në përqindje mbi numrin total të nëpunësve të trajnuar.

Grupet e synuara për vitin 2017



Krahasimi/Grupet e synuara për vitet 2014- 2017



Indikatorët që lidhen me menaxhimin e trajnimit kanë vazhduar të shënojnë përmirësimë si në aspektin sasior, por veçanërisht në atë cilësor me zbatimin e standardeve të kontrollit dhe menaxhimit të cilësisë së kurrikulave dhe shtimin e numrit të ditëve të trajnimit mesatar për një nëpunës civil, nëpërmjet hartimit, organizimit dhe zhvillimit të programeve afatgjata të trajnimit.

Me qëllim rritjen e cilësisë së trajnimit, si dhe të paturit kurrikula cilësore në përputhje me standardet dhe metodologjinë e zhvillimit të trajnimit (implementimi i metodave inovative), ASPA ka përdorur platformën e-learning si një metodologji të re trajnimi që është e aksesueshme në faqen zyrtare të saj. Gjatë vitit 2017 ky kurs është ndjekur nga **494 pjesëmarrës** në nivelin qendror dhe **771 nëpunës** civilë në nivel lokal.

ASPA gjatë vitit 2017, ka konsoliduar librarinë dixhitale³⁸ duke e pasuar me kurrikula për pushtetin qendror dhe vendor. Gjithashtu u konsolidua “Metodologja e Vlerësimit të Cilësisë, bazuar në standarte dhe kritere”. **Gjatë vitit 2017 janë publikuar në e-librari 76 kurrikula.** Tematikat sipas materialeve kurrikulare dhe manualet përkatës janë ofruar për të kaluar paraprakisht sistemin e vlerësimit të cilësisë (SVC). Për këtë proces u angazhuan rreth 28 ekspertë të fushave të ndryshme, për vlerësimin e cilësisë së kurrikulave.

Ndër të tjera, gjatë vitit 2017 u realizua matja e ndikimit të trajnimit³⁹ në performancën e nëpunësit civil. Matja e ndikimit u realizua për trajnimet në kuadër të rritjes së kapaciteteve për harmonizimin e legjislacionit ekonomik e tregtar të Shqipërisë me aktet e BE-së, për zbatimin e

³⁸ Libraria dixhitale është një sistem inteligjent i ndërtuar në faqen zyrtare që realizon menaxhimin e të gjithë kurrikulave të trajnimit që përdor Shkolla Shqiptare e Administratës Publike për trajnimin e nëpunësve civilë dhe të punonjësve të tjerë buxhetorë.

³⁹ Nga analiza e të dhëna rezultoi se: (i) 82% e pjesëmarrësve vlerësojnë se aftësitet e fituara nga të trajnuarit ishin të nevojshme dhe demonstrojnë sukses në mënyrën e përgatitjes dhe zhvillimit të trajnimit; (ii) Trajinimet e kryera ia kanë arritur qëllimit nëpërmjet kombinimit të formimit teorik me ushtrimin praktik të aftësive të fituara, si dhe në përdorimin e aftësive të fituara në vendin e punës shumica e të intervistuarve e kanë gjetur hapësirën.

legjislacionit të harmonizuar, si dhe përgatitja e administratës publike për zhvillimin e negociatave të anëtarësimit me BE-në.

Indikatori 6a.	Vlera 2017
Qarkullimi vjetor (lëvizja paralele) e stafit të nivelit drejtues në të gjitha nivelet shërbimit civil në institucionet e administratës qendrore	n/a

Ky indikator llogaritet duke pjesëtuar numrin e stafit drejtues në të gjitha nivelet e shërbimit civil në institucionet e administratës qendrore që janë larguar nga pozicionet e tyre në një vit/pjesëtuar me numrin total të stafit drejtues në administratën qendrore në vitin e dhënë. Për shkak të metodologjisë së përllogaritjes dhe ndryshimeve të ndodhura në gjysmën e dytë të vitit 2017 (ristrukturimi i ministritive) numri i ri i pozicioneve në shërbimin civil, i cili është i ndryshëm në gjysmën e dytë të vitit krasimisht me gjysmën e parë, e bën të pamundur matjen e saktë të kësaj vlerë dhe krasimin ndërvite.

Indikatori 6 b 1.	Vlera 2017
Numri mesatar i pjesëmarrësve nga jashtë shërbimit civil që marrin pjesë në një procedurë rekrutimi	9, 9 ⁴⁰

Indikatori 6b 2.	Vlera 2017
Numri mesatar i pjesëmarrësve brenda shërbimit civil që marrin pjesë në një proces rekrutimi	1.37 ⁴¹

Për dy indikatorët e mësipërm, edhe pse në vlera absolute shënohet rënie e vogël, duhet të mbajmë në konsideratë se përgjatë vitit 2017 u zhvilluan procedura rekrutimi për një periudhë tepër të shkurtër kohore (vetëm 4 disa muaj). Si rezultat të gjitha të dhënat në lidhje me këtë proces janë për një periudhë kohore më të shkurtër se sa vitet paraardhëse.

Më datë 1 Qershor 2017, Këshilli i Ministrave miratoi Vendimin nr. 473, datë 01/06/2017, “Përmarrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë për vitin 2017”. Qëllimi i këtij vendimi dhe krijimi i Task Forcës, në përbërje të së cilës kishte edhe përfaqësues të qeverisë, përfshirë ministrat teknikë dhe Zëvendëskryeministren teknike, ishte monitorimi dhe parandalimi i përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore gjatë periudhës së fushatës elektorale. Vlen të theksohet se gjatë kësaj periudhe pati një sërë vështirësish dhe problematikash në menaxhimin e shërbimit civil, që u reflektoan në tejkalim të kompetencave nga ana e ministrave teknikë, duke ndërrhyrë në menaxhimin e shërbimit civil përmes lëshimit të urdhreve për pezullimin e Sekretarëve të Përgjithshëm dhe Drejtoreve të Përgjithshëm, çka vjen ndesh me legjislacionin e shërbimit civil.

⁴⁰ Shënohet ulje me vetëm 0.1

⁴¹ Shënohet një ulje me vetem 0.3

Në këto kushte, Departamenti i Administratës Publike pezulloi shpalljet e pozicioneve vakante, pezullim i cili zgjati edhe pas përfundimit të zgjedhjeve për arsyet e riformatimit të kabinetit qeveritar dhe procesit të miratimit të strukturave dhe organikave të ministritive të reja. Theksojmë këtu se u pezulluan shpalljet e reja të pozicioneve vakante dhe jo procedurat e rekrutimit përvendet vakante që ishin shpallur më parë.

Në këto kushte, duhet theksuar se Departamenti i Administratës Publike për vitin 2017, shpalli procedura rekrutimi vetëm për një periudhë 4 mujore. Si rezultat të gjitha të dhënata në lidhje me këtë proces janë për një periudhë kohore më të shkurtër se sa vitet paraardhëse.

Përsa i takon indikatorit të mëposhtëm 6c, për vitin 2017 kjo vlerë shënon 0, krahasimisht me 1 ankesë të pranuar nga gjykata për çështje që ka të bëjë me rekrutimin në periudhën e mëparshme të raportimit (viti 2016).

Indikatori 6c.	Vlera 2017
Numri i ankesave kanë të bëjnë me rekrutimin në shërbimin civil të pranuar nga gjykata (duke filluar nga gjysma e dytë e vitit 2014) ka shënuar rënie	0

Nisur nga vlerat 0 apo 1 të këtij indikatori ndër vite, sugjerohet rishikimi i tij dhe formulimi i një indikatori tjeter i cili do të masë më saktë çka synohet të arrihet nën këtë objektiv.

Vlera e indikatorit të mëposhtëm ka vijuar të mbeten konstante nga vlerësimi i vitit 2015 i SIGMA.

Indikatori 6d.	Vlera 2017
Shkalla në të cilën sistemi trajnimi i nepunësve civil është funksional dhe zbatohet në praktikë (Indikatori i SIGMA-s)	3

Ky tregues nuk ka pësuar ndryshime krahasuar me nivelin e tij të vitit 2016.⁴²

Në drejtim të **Objektivit 7 “Organizimi i sistemit të pagave në shërbimin civil duke u bazuar në vlerësimin e vendit të punës, të arritjeve vjetore të nepunësve civilë dhe rezultateve në trajnimet e detyrueshme”** janë parashikuar 3 produkte për të cilat është parashikuar të nisë zbatimi i tyre pas nisjes së Projektit IPA 2014 “Zbatimi i reformës së shërbimit civil në administratën publike”.

Indikatori 7a.	Vlera 2017
Tarimi i sistemit të pagave dhe arritja e raportit 22,1 në vitin 2020 ndërmjet pagës maksimale dhe minimale.	8,6 %

⁴² Shih OECD/SIGMA Raporti Vlerësimi 2017 “Parimet e Administratës Publike” fq. 63

Indikatori 7b.	Vlera 2017
Rritja e variacionit/ numrit të pozicioneve në skemën e pagave bazuar në përshkrimin e punës	0

Një nga objektivat e rëndësishme të reformes së shërbimit civil dhe vetë Strategjisë është ai i Organizimit të sistemit të pagave në shërbimin civil duke u bazuar në vlerësimin e vendit të punës, të arritjeve vjetore të nëpunësve civilë dhe rezultateve në trajnimet e detyrueshme (Objektivi 7). Projekti IPA 2014 “*Mbështetje për zbatimin e reformës së shërbimit civil në administratën publike*” do të mbështesë administratën në realizimin e masave të parashikuara për këtë Objektiv. Projekti ende nuk ka nisur dhe pritet të fillojë brenda tre-mujorit të tretë të vitit 2018. Vlerat e të dy indikatorëve mbeten të njëjtë krahasimisht me vitin 2016.

Indikatori 7c.	Vlera 2017
Shkalla në të cilën sistemi i shpërblimit të nëpunësve civilë është i drejtë dhe transparent dhe zbatohet në praktikë (Indikatori i SIGMA-s)	3

Në vlerësimin e OECD/SIGMA ky tregues ka pësuar rënie nga niveli 4 në në vitin 2015 në nivelin 3 në vitin 2017. Sipas këtij vlerësimi “*promovimi vertikal dhe rritja e pagave mbeten të vetmet mënyra për të përmirësuar kushtet e pagave*” dhe ndryshimet e bëra në legjislacionin shqiptar ende nuk po siguron një sistem koherent të pagave. Me qëllim adresimin e kësaj situate në kuadër të assistencës së IPA-s do të realizohet një studim i cili do t'i hapë rrugë përmirësimit të sistemit të pagave dhe zvogëlimin e hendekut me tregun privat.


Shtylla IV: Procedurat Administrative dhe Mbikëqyrja

Reformat e parashikuara nën këtë fushë orientohen drejt arritjes së katër objektivave të mëposhtme:


- ❖ *Zbatimin e procedurave të thjeshtuara për ofrimin e shërbimeve, duke lehtësuar komunikimin me publikun dhe shmangur korruptionin;*
- ❖ *Zhvillimin e një infrastrukturë TIK të aftë për të mbështetur veprimtaritë e përditshme të administratës publike dhe rritjen e eficiencës duke ulur kohën për të aksesuar, përpunuuar dhe transmetuar informacionin ndërsa përmirësohet rrjedha e informacionit;*
- ❖ *Rritjen e eficiencës dhe përgjegjshmërisë së nëpunësve publikë;*
- ❖ *Rritjen e kontrollit mbi veprimtarinë e administratës publike, garantimi i të drejtave të qytetarëve dhe aksesi në informacion.*

Kjo shtyllë përmban 17 produkte nga të cilat 16 kanë filluar zbatimin.

Grafiku 17: Numri i produkteve në zbatim sipas Objektivave



Grafiku 18: Statusi i realizimit të produkteve sipas Objektivave



Progresi kundrejt secilit objektiv

Në kuadër të **Objektivit 8 “Procedura të thjeshtuara për ofrimin e shërbimeve, duke lehtësuar komunikimin me publikun dhe shmangur korruptionin”** janë parashikuar gjithsej 7 produkte të cilat kanë filluar të gjitha zbatimin dhe janë realizuar plotësisht 5 prej tyre deri në fund të vitit 2017 (duke shënuar rritje me një produkt krahasimisht me periudhën e mëparshme raportuese).

Me qëllim përbushjen e këtij objektivi, gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2017 nisi zbatimi i kontratës “*Procesi i Ri-inxhinierimit për Qendrën e Ofrit të Shërbimeve Publike të Integruar*”, për **400+** shërbimeve të ofruara nga **10** institucione publike. Synimi është ulja e kohës së lëvrimit të

shërbimit nga institucionet përkatëse me rrith 25% dhe ulja e ndjeshme e barrës administrative për qytetarin. Gjitashtu, ky proces gjen pikënisje në parimin e “*qeverisë si një e tërë*” dhe synon të eliminojë detyrimin e qytetarit/biznesit për të paraqitur në institucione publike, të dhëna që gjenden në databaza/arkiva shtetërore⁴³.

Indikatori 8a.	Vlera 2017
Numri i shërbimeve me procedurave të thjeshtësuara për ofrimin e tyre	0

Përsa i takon indikatorit të mësipërm, niveli faktik për vitin 2017 është 0. Produktet e konsulencës për ri-inxhinierimin e shërbimeve publike të 10 institucioneve në fokus, përkatësisht **382** harta të reja procesi, janë miratuar nga institucionet në fjalë, dhe pritet miratimi i tyre nga Këshilli i Ministrave. *Arritjet kundrejt nivelistës së synuar për vitin 2017⁴⁴ janë për pasojë në nivelin 0%*.

Në zbatim të Reformës së Deregullimit, e cila ka si qëllim përmirësimin e shërbimeve publike, nëpërmjet uljes së numrit të dokumenteve, si dhe kalimin online të tyre, ADISA ka nisur procesin përgatitjen e një pasqyre mbi informacionet e dërguara nga disa ministri⁴⁵. Grupi i Punës i ngritur nga ADISA ka përgatitur një pasqyrë me shërbimet përkatëse, dokumentet që eliminohen ose integrohen, kodin e shërbimit, nivelin e shërbimit, si dhe krahasimin me rekomandimet që disponon ADISA nga konsulenti i ri-inxhinierimit për procesin e ri-inxhinierimit të shërbimeve publike.

Në mënyrë që të sigurojë cilësinë dhe aksesin në lëvrimin e shërbimeve publike, por edhe të mundësojë një përvojë të unifikuar të qytetarëve në procesin e lëvrimit të shërbimeve publike, **ADISA ka standardizuar një total prej 128 formularësh për 301 shërbime publike** për disa institucione⁴⁶, si dhe ka përpiluar një total prej **562** Kartela Informative të shërbimeve publike⁴⁷ qëllim informimin e qytetarëve mbi mënyrën e aplikimit, dokumentet e kërkua të aplikimit, tarifat, afatet etj. Janë realizuar dy sondazhe për matjen e kënaqësisë qytetare në sportelet pritëse të ZVRPP Tiranë, përkatësisht në muajt Shkurt dhe Korrik 2017. Në përgjithësi të intervistuarit kanë vlerësuar me **mbi 90%**

⁴³ Të gjitha shërbimet publike administrative, të përkufizuara sipas Ligjit Nr. 13/2016, datë 18.02.2016, janë analizuar bazuar në 4 hapat kryesore të shërbimit: (i).Përgatitja për të marrë shërbimin; (ii).Aplikimi (në sportelet e zyrave pritëse apo online); (iii).Procesimi në zyrat përpunuese; (iv).Kanali i dorëzimit.

⁴⁴Niveli i synuar për vitin 2017 është 150 harta të produhuara dhe të miratuar nga Këshilli i Ministrave (referuar te Pasaporta e Indikatorëve, fq. 24).


⁴⁵ Ministria e Drejtësisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Kulturës, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Brendshme, si dhe institucionet e varësisë.

⁴⁶ AQTN, ATP, DPD, DPB, DPGJC, DPSHTRR, ISSH, MSHMS, SHSSH, QSHA, ZRPP, DPT, ALUIZNI, SHKP, QKB, FSDKSH dhe MASR


⁴⁷ ATP, AQTN, ABSA, DPD, DPB, DPSHTRR, DPGJC, MASR, FSDKSH, ISSH, QKB, ZRPP, SHSSH, SHKP, MZHU, AZHT, DPT, ALUIZNI, DPP dhe QSHA

pozitivisht ndryshimet e kryera nga ADISA. Nga analizimi i të dhënave, vihet re një rritje e dukshme e nivelit të kënaqësisë qytetare në të gjithë indikatorët e analizuar me periudhën para hapjes së zyrave pritëse. Gjithashtu, nga muaji Shkurt deri në muajin Korrik ka përmirësim të dukshëm të nivelit të kënaqësisë qytetare. Më poshtë paraqitet grafikisht përmirësimi i nivelit të kënaqësisë qytetare sipas indikatorëve të ndryshëm për matjen e performancës për shkallën “shumë të kënaqr”:

Grafiku 19: Niveli i kënaqësisë qytetare në sportelet pritëse ZVRPP Tiranë



Grafiku 20: Niveli i kënaqësisë qytetare në sportelet pritëse të Qendrës së Integruar Kavajë



Gjatë vitit 2017 janë realizuar dy sondazhe për matjen e kënaqësisë qytetare në Qendrën e Integruar ADISA Kavajë, përkatësisht në muajt Janar dhe Mars 2017. Në përgjithësi të intervistuarit kanë vlerësuar me mbi 95% pozitivisht ndryshimet e kryera nga ADISA. Nga analizimi i të dhënave, vihet re rritje e dukshme e nivelit të kënaqësisë qytetare në të gjithë indikatorët e analizuar me periudhën para hapjes së zyrave pritëse. Gjithashtu, nga muaji Janar në muajin Mars ka përmirësim të dukshëm të nivelit të kënaqësisë qytetare. Më poshtë paraqitet grafikisht përmirësimi i nivelit të kënaqësisë qytetare sipas indikatorëve të ndryshëm për matjen e performancës për shkallën “shumë të kënaqr”:

Gjithashtu Sondazhet online janë realizuar me votim të hapur për të gjithë qytetarët në faqen zyrtare të ADISA nëpërmjet pyetjes “*Si i vlerësoni ndryshimet e kryera nga ADISA në cilësinë e ofrimit të shërbimit?*”, për FO ADISA ZVRPP Tiranë dhe për Qendrat e Integruar në Kavajë, Krujë, Fier dhe Gjirokastër. Në përgjithësi, niveli i vlerësimeve online është i lartë. Më së shumti vlerësohen ndryshimet e kryera në Qendrat e Integruar Fier dhe Gjirokastër.

Duke patur parasysh analizat e mësipërme për matjen e kënaqësisë qytetare në sportelet pritëse në ZVRPP Tiranë dhe në Qendrën e Integruar në Kavajë, si dhe rezultatet e sondazheve online, ky indikator ka **progres në rritje** krahasuar me periudhat para hapjes së Qendrave të Integruar ADISA dhe me muajt respektivë në të cilët janë zhvilluar sondazhet gjatë vitit 2017.

Arritjet kundrejt nivelit të synuar për vitin 2017⁴⁸ janë realizuar.

Indikatori 8b.	Vlera 2017
Niveli (%) e kënaqshmërisë publike kundrejt cilësisë së ofrimit të shërbimeve	Tendencë në rritje

Referuar pasaportës së Indikatorëve, niveli i synuar për vitin 2017 është tendencë në rritje. Nuk mund të matet me një vlerë të përgjithshme sepse sondazhet i referohen periudhave të ndryshme kohore dhe sportelevë të shërbimit të institucioneve të ndryshme. Gjatë sondazheve të zhvilluara në ZVRPP Tiranë, niveli i kënaqësisë qytetare ka tendencë rritëse **nga niveli 31% para hapjes së sportelevë pritëse, në nivelin 58% në muajin Shkurt 2017 dhe 76% në muajin Korrik 2017** (Grafiku 19). Gjatë sondazheve të zhvilluara në Qendrën e Integruar Kavajë, niveli i kënaqësisë qytetare ka tendencë rritëse nga niveli 25% para hapjes së sportelevë pritëse, në nivelin 74% në muajin Janar 2017 dhe 87% në muajin Mars 2017 (Grafiku 20).

Indikatori 8c.	Vlera 2017
Shkalla në të cilën politikat për ofrimin e shërbimeve të fokusuar tek qytetari janë miratuar dhe zbatuar në praktikë	3

Ky tregues ka pësuar rritje krahasuar me vlerësimin e vitit 2015, niveli i të cilit ishtë 2. Raporti i vlerësimit të OECD/SIGMA⁴⁹ vlerëson së politikat e ndërrmara nga Qeveria dhe miratimi i një sërë dokumentash politike dhe legjislacioni lidhur me ofrimin e shërbimeve për qytetarët.

Padyshim që përtej elementëve të suksesit, ka patur edhe disa sfida me të cilat jemi përballur gjatë vitit 2017, në pikëpmapje të përbushjes së këtij Objektivi, të tilla si:

- > *Sfida buxhetore* -mosalokimi i fondevë te nevojshme per infrastrukturën TIK per akomodimin e rekomandimeve përkatëse;
- > *Sfida teknike* - mosvalidimi i informacionit nga ana e institucioneve;
- > *Sfida legjislatieve* - mosmiratimi i aktit nënligjor per implementimi ne procesit te riinxhinierimit te shërbimeve publike.

Përsa i përket **Objektivit 9 “Zhvillimi i një infrastrukturre TIK të aftë për të mbështetur veprimtaritë e përditshme të administratës publike dhe rritjen e eficënsës duke ulur kohën për të aksesuar, përpunuuar dhe transmetuar informacionin ndërsa përmirësohet rrjedha e informacionit”** kanë filluar zbatimin 4 produkte të parashikuara në total, si dhe 3 prej tyre janë realizuar plotësisht.

Gjatë vitit 2017 në drejtim të realizimit të këtij objektivi më poshtë do të përmendim shkurtimisht disa nga arritjet konkrete për periudhën raportuese :

⁴⁸Niveli i synuar për vitin 2017 është tendencë në rritje (referuar Pasaporta e Indikatorëve, fq. 25).

⁴⁹ Shih OECD/SIGMA Raporti Vlerësimi 2017 “Parimet e Administratës Publike” fq. 108

Portali unik qeveritar e-Albania ka ofruar rreth **527** shërbime elektronike si dhe janë regjistruar **151,439** përdorues të rinj dhe në total prej vitit 2013, përllogariten **391,060** përdorues të regjistruar. Nga përdoruesit e regjistruar për këtë periudhë raportuese, 3% e tyre i përkasin profilit biznes dhe 97% e të regjistruarve i përkasin profilit qytetar.

Gjithashtu në **Platformën Ndërqeveritare të Ndërveprimit** u lidhën 5 institucione të tjera për të shkëmbyer të dhëna në kohë reale duke e rritur numrin total të institucioneve të lidhura në **47**. Kjo lidhje bën të mundur kommunikimin dhe shkëmbimin e të dhënavë midis institucioneve të ndryshme duke krijuar mundësinë e ofrimit të më shumë shërbimeve elektronike për qytetarët, bizneset dhe vet qeverinë.

Gjatë vitit 2017 pati një rritje në mbi 1,000,000 transaksione më shumë në krahasim me vitin 2016 të numrit të transaksioneve të kryera në platformë duke arritur **në 26,624,830 transaksione**.

Në drejtim të lehtësimit të aksesit për qytetarët dhe bizneset në shërbimet elektronike u ndërmorr një iniciativë e rëndësishme e ofruar nga portali unik qeveritar e-Albania e cila ishte **vula dixhitale** dhe **moduli i administratës publike** për nxjerrjen e dokumenteve administrative për qytetarin. Portali e-Albania përdoret nga punonjësit e administratës publike për të marrë vërtetime dhe dokumente të cilat gjenden si shërbime të portalit (me vulë dixhitale) për plotësimin e dokumentacionit shoqëruar të shërbimit të kërkuar nga qytetari. Këto dokumente nuk i kërkohen më vetë qytetarit gjatë marrjes së një shërbimi publik.


Deri në fund të vitit 2017, janë **29** dokumente me vulë që ofrohen në modul për nëpunësit e administratës publike që merren me procedurat e ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarëve me qëllim përmirësimin e disponueshmërisë, cilësisë dhe transparencës së shërbimeve publike si dhe reduktimin e kohës së zbatimit të procedurave dhe kostove të administratës publike. Deri në fund të vitit 2017 janë regjistruar në modul në total **102** institucione dhe **4,720** përdorues.

Ndër shërbimet më të përdorura të vitit 2017 janë aplikimet për leje ndërtimi, të cilat numërojnë mbi **10,000** aplikime, aplikimet për shërbimet konsullore për shqiptarët jashtë vendit të cilat numërojnë mbi **40,000** aplikime, shërbimi elektronik për maturën shtetërore i cili mundësoi mbi **30,000** aplikime të sukseshtme për maturantët, apo mbi **12,000** aplikime për kartë shëndeti. Shërbimet e ofruara me vulë dixhitale kanë pasur po ashtu një përdorim të gjerë veçanërisht pas muajit shtator 2017.

Certifikatat e gjendjes civile, shtatë vërtetime nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, vërtetimet e pensionit, karta e shëndetit etj., janë ndër dokumentet më të shkarkuara nga portali.

- **279,906 certifikata të gjendjes civile të gjeneruara nga portali e-Albania;**
- **13,995,300 lekë të reja kursim qytetarëve;**
- **74,928 vërtetime tatimore;**
- **18,723 orë pritje nëpër radhë ose dy vite e dy muaj duke shmangur dhe veprime të tjera burokratike që do të sillnin kosto të tjera për biznesin (duke konsideruar mesatarisht pritje 15 minuta për një vërtetim).**

Grafiku 22: Shërbimet më të përdorura në 2017



*Krahasimisht me vitin e kaluar, vlera e indikatorit 9a. mbetet e njëjtë.

Indikatori 9a.	Vlera 2017
Sisteme të përmirësuara të IT-së për ofrimin e shërbimeve	4

Indikatori 9b.	Vlera 2017
Shkalla në të cilën janë të zbatueshme parakushtet politike dhe administrative për ofrimin e shërbimeve elektronike (Indikatori i SIGMA-s).	Tendencë në rritje

Përsa i përket **Objektivit 10 “Rritja e eficencës dhe përgjegjshmërisë së nepunësve publikë”** janë parashikuar gjithsej 4 aktivitete prej të cilave 3 kanë nisur zbatimin deri në fund të vitit 2017. Ndër këto 2 prej aktivitetave për të cilat ka nisur zbatimi janë realizuar plotësisht.

Indikatori 10a.	Vlera 2017
Shkalla në të cilën kuadri ligjor për administrimin e mirë është miratuar dhe zbatuar në praktikë (Indikatori i SIGMA-s.)	3

Ky tregues ka pësuar përmirësimë kundrejt matjes së vitit 2015, i cili ka qenë në nivelin 2. Ky vlerësim lidhet kryesisht me miratimin e Kodit të ri të Procedurave Administrative dhe adoptimin e një sërë procedurash standarde të ofrimit të shërbimeve.

Përsa i përket **Objektivit 11 “Rritja e kontrollit mbi veprimtarinë e administratës publike, garantimi i të drejtave të qytetarëve dhe aksesi në informacion”** janë parashikuar gjithsej 2 aktivitete të cilat kanë nisur zbatimin dhe janë realizuar plotësisht në 2017 .

Gjatë vitit 2017, Zyra e Komisionerit ka vijuar punën lidhur me zbatimin dhe monitorimin e Ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” i cili kryhet nëpërmjet monitorimit të elementeve të ndryshëm të ligjit si psh.: numri i autoriteteve publike që kanë hartuar programet e transparencës, koordinatorë të caktuar nga autoritetet publike, përditësimi i regjistrat të kërkesave dhe përgjigjeve, numri i ankesave të shqyrtuara, hetimet e kryera, seanca dëgjimore të zhvilluara si dhe vendimet e dhëna.

Gjatë vitit 2017, Zyra e Komisionerit jo vetëm ka monitoruar faqet zyrtare të Autoriteteve Publike, por ka kryer inspektime në terren si dhe ka kërkuar informacion lidhur me përbushjen e detyrimeve që burojnë nga Ligji nr. 119/2014, si:

- *Publikimi i programeve të transparencës;*
- *Caktimi i koordinatorit për të drejtën e informimit;*
- *Publikimin e regjistrat të kërkesave dhe përgjigjeve.*

Nga monitorimi i autoriteteve publike ka rezultuar se **181** autoritete publike kanë miratuar dhe kanë bërë publik programin e transparencës; **227** autoritete publike kanë caktuar koordinator për të drejtën e informimit dhe **124** Autoritete Publike kanë publikuar regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve.

Nga monitorimi i autoriteteve publike për vitin 2017 ka rezultuar se institucionet të cilat kanë një program të plotë dhe të përditësuar transparence janë institucionet e pavarura. Gjithashtu institucionet e pavarura, kanë të njëjtët koordinatorë që kanë caktuar që me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”. Numri i kërkesave për informim të trajtuar nga këto institucione, gjatë vitit 2017 është 1303, ndërsa numri i kërkesave të refuzuara është 98.

Në lidhje me pushtetin vendor, Zyra e Komisionerit vlerëson se niveli i transparencës së bashkive shënon përmirësimë. Tashmë të gjitha bashkitë kanë caktuar koordinatorët e të drejtës për informim dhe numri i kërkesave për informacion publik të trajtuar nga bashkitë gjatë vitit 2017 është **9308**, ndërsa numri i kërkesave të refuzuara është **245**.

Më problematike situata e transparencës ka qenë për institucionet e pushtetit qendror. Edhe pse pati përmirësimë të dukshme 6 mujorin e parë të vitit 2017, referuar monitorimit, sipas të cilit të gjitha ministritë kishin caktuar koordinatorë të të drejtës për informim dhe programet e transparencës, kjo situatë pati ndryshime pas muajit qershor për shkak të zgjedhjeve elektorale si dhe ndryshimit kabinetit qeveritar. Ndryshimet konsistuan si në numër të ministrite ashtu edhe në fushat e kompetencave të secilës ministri. Për rrjedhojë, pati një përkeqësim të dukshëm lidhur me zbatimin e detyrimeve që burojnë nga Ligji “Për të Drejtën e Informimit”. Në një pjesë të

ministrive pati ndryshim të koordinatorëve të së drejtës për informim, në faqet e internetit të ministrive të reja ekzistonte një ikonë fiktive për programin e transparencës.

Gjatë vitit 2017, koordinatorët e të drejtës për informim të ministrive kanë trajtuar gjithsej 417 kërkesa për informacion publik dhe vetëm 3 prej tyre janë refuzuar.

Në zbatimin të Ligjit Nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” gjatë vitit 2017, pranë Zyrës së Komisionerit u depozituan **560** ankesa, prej të cilave **395** janë zgjidhur me ndërmjetësim. Për **66** ankesa, Komisioneri është shprehur me “Vendim”. Më tej, **77** ankesa kanë rezultuar jashtë objektit. **8** ankesa kanë qenë jashtë afatit dhe **14** ankesa kanë rezultuar të paplota.

Fakti që pjesa më e madhe e ankesave janë zgjidhur me ndërmjetësim tregon efektivitetin e ndërhyrjes së Zyrës së Komisionerit. Pjesa më e madhe e ankesave të shqyrtuara nga Zyra e Komisionerit kanë qenë ankesa të drejtuara nga qytetarët. Konkrektisht **430** ankesa janë depozituar nga qytetarët ndërsa **130** ankesa janë depozituar nga Organizata JoFitimprurëse (OJF). Fakti që numri më i madh i ankesave vinë nga qytetarët është një tregues mjaft i mirë i impaktit të ndërgjegjësimit të qytetarëve mbi të drejtën e informimit.

Zyra e Komisionerit ka realizuar **94** hetime administrative në fushën e të drejtës për informim me synim verifikimin e ankesave të depozituara. Gjithashtu, janë dhënë **66** vendime për Autoritetet Publike, prej të cilave **57** vendime urdhërimi, **3** vendime rrëzimi, si dhe **6** vendime me sanksione gjobe. Gjatë këtij viti janë realizuar **10** seanca dëgjimore.

Edhe këtë vit ka vijuar bashkëpunimi me Shkollën Shqiptare të Administratës publike me synim forcimin e kapaciteteve të administratës publike për zbatimin e duhur të ligjit. E drejta për informim ka qenë pjesë e programit të trajnimit të detyruar për nëpunësit civil në periudhë prove. Janë organizuar **18** kurse trajnuese në të cilat kanë marrë pjesë **555** nëpunës civil.

Për vitin 2017, **numri i ankesave të paraqitura çdo vit pranë Komisionerit, ka pasur tendencë në rënje** (indikatori 11.a). Sikurse është parashikuar dhe në pasaportën e indikatorëve nga **684** ankesa të shqyrtuara në vitin 2016 në vitin 2017 janë shqyrtuar **560** ankesa.

Lidhur me numrin e dënimive të aplikuara nga ana e Komisionerit kundrejt institucioneve, të cilat pas inspektimeve të kryera në bazë të raportimit, kanë rezultuar që nuk kanë dhënë informacion është **0,06** ndërsa në vitin 2016 kjo shifër ka qenë **0,03**.

Një nga sfidat kryesore të Zyrës së Komisionerit është rritja e përgjegjshmërisë së autoriteteve publike duke rritur kontrollin mbi veprimtarinë e administratës publike në garantimin e të drejtave të qytetarëve dhe aksesit në informacion.

Indikatori 11a.	Vlera 2017
Numri i ankesave të paraqitura çdo vit pranë Komisionerit përgjegjës për lirinë e informimit	560

Gjatë kësaj periudhe, Institucioni i Avokatit të Popullit ka adresuar në total **188** rekomandime drejtuar organeve të Administratës Publike duke përfshirë atë qendrore dhe vendore. Nga numri total i rekomandimeve rezulton se:

- **123** rekomandime janë pranuar;
- **29** rekomandime janë refuzuar;
- **24** rekomandime pa përgjigje;
- **12** rekomandime në proces.

Siq ju përmëndem më lartë 123 rekomandime janë të pranuara nga organet shtetërore, nga të cilat **80** rekomandime janë pranuar dhe zbatuar, ndërsa **19** rekomandime janë pranuar por nuk janë zbatuar. Ndërkokë, për **24** rekomandime që janë pranuar prej tyre, institucionet përgjegjëse nuk kanë dërguar informacion për ecurinë e zbatimit të tyre.

Nga numri i rekomandimeve të adresuara në total 188, rezulton se vetëm 123 prej rekomandimeve të pranuara dhe referuar raportit të rekomandimeve të pranuara me rekomandimet e zbatuara, rezulton se **65%** e rekomandimeve të pranuara kanë gjetur zbatim nga institucionet përkatëse.

Lidhur me rekomandimet pa përgjigje, evidentojmë se 24 rekomandime për vitin 2017, rezultojnë pa përgjigje nga institucionet shtetërore. Pra, në përputhje me raportin midis rekomandimeve pa përgjigje dhe rekomandimeve të adresuara në total nga Avokati i Popullit **rezulton se 12.7 % e rekomandimeve të adresuara nuk kanë përgjigje**.

Përsa i takon numrit të kërkesave për informacion, rezulton se për vitin 2017, institucioni i Avokatit të Popullit ka adresuar në total **2015 kërkesa për informacion**, prej të cilave 60 prej tyre rezultojnë pa përgjigje, ose 2.9% e kërkesave për informacion të adresuara nuk kanë marrë përgjigje nga institucionet përkatëse.

Në përfundim, nisur nga analizave e statistikave të mësipërme, për vitin 2017 rezulton dhe sikundër evidentohet ka një *rritje të numrit të rekomandimeve të pranuara në tërësi nga institucionet e Administratës Publike, si dhe, kemi një rritje në përqindje e rekomandimeve të zbatuara*. Ndërkokë që edhe lidhur me rekomandimet pa përgjigje rezulton se për vitin 2017 janë më pak rekomandime pa përgjigje, krahasuar me vitin 2016. Vlera e mëposhtme shënon rritjen, krahasimisht me 47.2% për vitin 2016.

Indikatori 11b.	Vlera 2017
Përqindja e rekomandimeve të zbatuara nga institucionet mbikëqyrëse të institucioneve të pushtetit qendror në dy vitet e kaluara.	65%

IV. Sfidat kryesore për zbatimin e Strategjisë në 2018

- **Në raportin e monitorimit të Strategjisë për vitin 2016, procesi i zgjedhjeve parlamentare u evidentua si një ndër sfidat më të mëdha me të cilat mund të përballej zbatimi i Strategjisë.** Funksionimi normal i administratës mund të kishte pontencialisht ndikime të drejtpërdrejtë apo indirekte si rezultat i situatës politike në vend. Përpos vështirësive sa i takon periudhës elektorale, emërimit të disa ministrale teknikë dhe drejtuesve të institucioneve të pavarura si pasojë e situatës zgjedhore, elementë të cilët patën ndikim e tyre në ritmin e zbatimit të Strategjisë, të dhënat tregojnë se krahasimisht me vitin e kaluar, **kemi një rritje prej 4% të aktiviteteve nën zbatim**. Me formatimin e kabinetit të ri qeveritar por edhe ristrukturimin e administratës qendrore, institucionet vijuan punën normalisht në pjesën më të madhe të rasteve, duke vazhduar të raportojnë mbi ecurinë e zbatimit të Strategjisë.
- **Hartimi dhe miratimi i Planit të ri të aktiviteteve për t'u zbatuar për periudhën 2018-2020,** në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike 2015-2020, duke siguruar edhe nevojat financiare në kuadër të Programit Buxhetor Afatmesëm është ndër sfidat e vitit 2018. Plani i Ri i Aktiviteteve duhet të jetë cilësor, ambicioz por edhe i arritshëm e mbi të gjitha duhet të jetë financiarisht i qëndrueshëm. Në këtë kontekst, ndër sfidat e hasura ka genë ngadalësia e reagimit të disa institacioneve lidhur me propozimet për aktivitetet e reja që do të përfshihen në planin e ri të veprimit.
- Sfidë për tre vitet e ardhshme mbeten realizimi i plotë i reformave të parashikuara në Strategji dhe mbi të gjitha përbushja e objektivave të parashikuara për të patur në fund të vitit 2020 një Strategji e cila mund të vlerësohet si e zbatuar mbi nivelin 80% të saj.
- Përmirësimi i planifikimit dhe koordinimit të politikave, vënia në zbatim e vlerësimit të ndikimit irregullator, përmirësimi i procesit të konsultimit publik duke bërë të mundur përfshirjen aktive dhe cilësore, procesi i de-rregullimit apo edhe ristrukturimi i agjencive dhe institucioneve të varësisë në pikëpamje të përmirësimit të ofrimit të shërbimeve, struktura e re e pagave, unifikimi i procedurave, funksionaliteti i plotë i HRMIS, forcimi i kapaciteteve të ASPA, etj. mbeten ndër sfidat kryesore përgjatë vitit 2018 e më tej.
- **Në përfundim, një nga sfidat mbetet dhe prezantimi i singertë dhe i hapur i problemeve që ndeshën në zbatimin e strategjive.** Kjo kërkon një ndryshim në kulturën e punës së administratës shqiptare: kulturën e analizës dhe evidentimit të problematikave në mënyrë sa më objektive. Në këtë kontekst, hapa pozitive u bënë fillimisht në vitin 2016 në raportin e dytë të monitorimit të strategjisë i cili prezantoj sfidat dhe risqet e mundshme. Megjithatë, një qasje e tillë duhet të jetë sistematike dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet teknike, menaxheriale dhe politike.

- ***Reforma e administratës publike duhet të vijojë të mbetet në fokus dhe vëmendje të të gjithë aktorëve*** sidomos në situatën kur Shqipëria pret çeljen e negociatave me Bashkimin Evropian. Suksesi i këtyre negociatave lidhet drejtpërdrejtë me profesionalizmin dhe përkushtimin e punonjësve të administratës publike si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal.